

# **TIK 8**

# **UDHËZUES PËR MËSUESIN**



## Miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit

Botues: IRISOFT EDUCATION  
Esmeralda TASHO

Redaktore letrare:  
Ortensa MARINI

Arti grafik:  
Zamir BRAHIMAJ

© IRISOFT EDUCATION 2016

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Riprodhimi i librit, qoftë edhe në formë të pjeshme është i ndaluar.

Botim i parë 2016

Shtypur në shtypshkronjën *Classicprint*

Shtëpia Botuese IRISOFT EDUCATION  
Rruga "Him Kolli"; V. 23/1  
Tel: 00355 2242 107;  
Mob: 069 40 970 40  
e-mail: [info@irisoft.al](mailto:info@irisoft.al)  
[www.irisoft.edu.al](http://www.irisoft.edu.al)



---

---

**Përmbajtja e lëndës**

I. Hyrje	faqe 4
II. Korniza konceptuale e programit	faqe 4
1. Qëllimi i programit të fushës së TIK-ut	faqe 5
2. Kompetencat e fushës	faqe 5
3. Kompetencat kyçe	faqe 6
4. Lidhja e kompetencave kyç me kompetencat e fushës	faqe 6
5. Koha mësimore për secilën klasë	faqe 7
6. Orë të sugjeruara për çdo tematikë	faqe 8
7. Përmbajtja e shkallës së pestë	faqe 8
8. Tematikat e TIK 10	faqe 8
9. Programi analitik	faqe 12
10. Planifikimi 3-mujor	faqe 16
11. Planifikimi ditor (ditari)	faqe 29

## I. Hyrje

Në ditët e sotme, teknologjia dhe TIK-u janë kthyer në një mënyrë jetese ndaj së cilës nxënësit shfaqin mjaft interes. Arsimit teknologjik është një përbërës thelbësor i kurikulës, ku nxënësit zhvillojnë aftësitë digjitale për të përdorur TIK-un në mënyrë efektive dhe të përshtatshme për të pasur akses, për të krijuar dhe komunikuar informacion dhe ide, për të zgjidhur probleme dhe për të punuar së bashku në të gjitha fushat e edukimit në shkollë dhe në jetën përtej shkollës. Aftësia e TIK-ut i përfshin nxënësit në procesin e të mësuarit për teknologjinë digjitale, duke e bërë të vlefshme për ta për t'iu përshtatur si teknologjive që evoluojnë, ashtu edhe për t'u dhënë njohuri mbi kufizimin e rreziqeve për veten në një mjedis digjital. Për të marrë pjesë në një ekonomi të bazuar në dije dhe për të qenë të fuqishëm në një shoqëri teknologjike të sofistikuar për të sotmen dhe për të ardhmen, nxënësve u nevojiten njohuri, aftësi dhe besim në TIK, për të realizuar detyrat në shkollë, shtëpi, punë dhe në komunitetet e tyre. Si qytetarë, ata duhet të jenë të aftë të bëjnë gjykime vetjake mbi çështjet që lidhen me ndikimin e teknologjisë në jetët e tyre, në shoqëri dhe në mjedis.

## II. Korniza konceptuale e programit

Hartimi i programit lëndor rrjedh nga *korniza kurikulare e arsimit të mesëm të ulët, plani mësimor për kurikulën në arsimin e mesëm të ulët*, si dhe *standardet e fushës kurikulare* ku kjo lëndë bën pjesë. Për të siguruar përdorimin sa më të mirë të programit, është e vlefshme njohja me dokumentet e lartpërmenduar. Te korniza kurikulare, vëmendje të veçantë i duhet kushtuar:

- synimeve të përgjithshme të kurikulës së arsimit bazë;
- synimeve të temave ndërkurikulare;
- vlerësimin të nxënësit me notë;
- parimeve të mësimdhënies/mësimnxënies.

Në mënyrë që tërësia e dokumenteve zyrtare (korniza kurikulare, standardet e fushës së të nxënësve dhe programi lëndor) të zbatohet më së miri në dobi të nxënësve, përdoruesit e kësaj tërësie duhet të njohin thellë programet lëndore të TIK-ut për klasat paraardhëse dhe klasat pasardhëse. Gjithashtu, përdoruesve të këtij programi u lind nevoja të njohin standardet e të gjitha fushave të tjera të të nxënësve dhe të gjitha programet e lëndëve të të njëjtit vit. Zbatimi i këtij programi kërkon që kurikula e TIK-ut të vendosë theksin në rrugën dhe procedurat e veprimit shkencor me objektet

mësimore, që metodat verbale të përdorura gjerësisht sot, të zëvendësohen me përdorimin e metodave shkencore.

Si i tillë, ky dokument i shërben:

**Nxënësit**, për zhvillimin e kompetencave kyç dhe kompetencave të fushës së teknologjisë dhe TIK-ut, në mënyrë që ata të përballojnë sfidat e jetës dhe të integrohen në shoqëri.

**Mësuesve**, për planifikimin, realizimin dhe vlerësimin e veprimtarisë mësimore dhe arritjet e nxënësve në klasë dhe jashtë saj.

**Prindërve**, për njohjen e rezultateve të fëmijëve të tyre dhe kriteret e vlerësimit në periudha të caktuara kohore.

**Hartuesve** të teksteve mësimore dhe të materialeve ndihmëse për mësuesit dhe nxënësit.

Programi përmban pesë tematika, të cilat krijojnë kushte që nxënësi/ja të ndërtojë dhe zbatojë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat, në funksion të kompetencave të lëndës dhe kompetencave kyç. Në program paraqitet edhe **koha mësimore për secilën tematikë**, që ndryshon nga klasa në klasë.

### 1. Qëllimi i programit të fushës së TIK-ut

Programi i TIK-ut ka për qëllim të zhvillojë njohuritë, të kuptuarit dhe aftësitë për të siguruar nxënësit që, individualisht dhe në bashkëpunim:


- të hetojnë, projektojnë, planifikojnë, menaxhojnë, krijojnë dhe vlerësojnë zgjidhjet;
- të jenë krijues, inovativë dhe me iniciativë kur përdorin tradicionalen, bashkëkohoren dhe teknologjitë e reja dhe të kuptojnë se si janë zhvilluar teknologjitë me kalimin e kohës;
- të marrin vendime të informuara dhe etike në lidhje me rolin, ndikimin dhe përdorimin e teknologjive në ekonomi, mjedis dhe shoqëri për një të ardhme të qëndrueshme;
- të angazhohen me besim dhe përgjegjësi që të zgjidhin dhe të manipulojnë me teknologjitë e përshtatshme - materialet, të dhënat, sistemet, komponentet, mjetet dhe pajisjet - kur projektojnë dhe krijojnë zgjidhje;
- të kritikojnë, analizojnë dhe vlerësojnë problemet, nevojat apo mundësitë për të identifikuar dhe për të krijuar zgjidhje.

### 2. Kompetencat e fushës

Vazhdimësia e aftësisë TIK të të mësuarit është e organizuar në pesë kompetenca të fushës, të ndërlydhura:

- zbatimi i protokolleve dhe i praktikave sociale dhe etike kur përdorin TIK-un;
- hetimi me TIK;
- krijimi me TIK;
- komunikimi me TIK;
- menaxhimi dhe veprimi me TIK.

### 3. Kompetencat kyçe



### 4. Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e fushës

Ndërtimi dhe zbatimi i kompetencave kyçe nga nxënësit gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies kërkon që mësuesi të ketë parasysh lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e fushës për secilën shkallë. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi duhet të përzgjedhë situatat, veprimtaritë, metodat, dhe mjetet e përshtatshme të procesit të të nxënës. **Kompetenca përcaktohet si integrim i njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve që një nxënës duhet t'i fitojë gjatë procesit të nxënies.**

Kompetenca demonstron nga nxënësi (njohuri), bazohet në performancën e tij (aftësi), si dhe bazohet në perspektivën e sjelljes (qëndrim). Organizimi i mësimit të TIK-ut me bazë kompetencat përqendrohet në atë që nxënësi duhet të dijë, të bëjë saktë dhe të shpjegojë pse e bën. Kur nxënësi realizon kompetencën digjitale, ai njëkohësisht është duke zhvilluar edhe kompetencat kyçe.

Për shembull, kompetenca digjitale “Zgjidhja problemore” përfshin shumë nga strategjitë e zgjidhjes së situatave të ndryshme problemore në shoqëri dhe në jetën e përditshme, duke përdorur teknologjinë.

Për të realizuar lidhjen e kompetencave kyç me kompetencat e fushës së TIK-ut, mësuesi ndjek këta hapa:

- përzgjedh rezultatin/et e të nxënit për kompetencat kyç që synon të arrijë nxënësi në shkallën përkatëse;
- përzgjedh rezultatin/et e të nxënit për shkallë për kompetencat e fushës/ lëndës së TIK-ut që synon të arrijë nxënësi;
- zbërthen në rezultate të nxëni për kompetencat e fushës/lëndës së TIK-ut për vit mësimor, rezultatin/et e të nxënit për shkallë;
- përzgjedh përmbajtjen/et mësimore, mjetet digjitale, metodologjinë e mësimdhënies, përmes të cilave realizon rezultatet e të nxënit të kompetencave digjitale një vit mësimor, si dhe rezultatet e të nxënit për kompetencat kyç në një vit mësimor;
- planifikon mësimdhënien duke përfshirë periudhën kohore gjatë së cilës do t’i arrijë rezultatet e të nxënit brenda vitit shkollor;
- kryen analiza dhe vlerësime të ecurisë së nxënësve pas realizimit të orëve mësimore, detyrave, projekteve, për të verifikuar arritjet e rezultateve të të nxënit për vit mësimor dhe shkallë për fushën e teknologjisë dhe TIK-ut.

### **5. Koha mësimore për secilën klasë**

Lënda e TIK-ut zhvillohet për 35 javë mësimore me nga 1 orë në javë pra gjithsej 35 orë për klasën e 8-të. Programi i lëndës së TIK-ut specifikon peshën (orët e sugjeruara) të secilës tematikë për secilën shkallë dhe klasë. Shuma e orëve sugjeruese për secilën tematikë është e barabartë me sasinë e orëve vjetore, të përcaktuara në planin mësimor të arsimit 9 vjeçar. Kjo ka si qëllim që përdoruesit e programit të orientohen për peshën që zë secila tematikë në orët totale vjetore.

## 6. Orë të sugjeruara për çdo tematikë

	Bota e kompjuterit	Përpunimi digjital i të dhënave	Kërkimi në web/ internet, email-I dhe chat-i	Hyrje në programim dhe Excel-i	Prezantimi digjital (Komunikimi Funksional)	Gjithsej orë
Shkalla e pestë						
Klasa e tetë	5 orë	6 orë	7 orë	10 orë	7 orë	35 orë

## 7. Përmbajtja e shkallës së pestë

Në programin e lëndës së TIK-ut për shkallën e pestë janë paraqitur përmbajtjet e tematikave:

- ***Bota e kompjuterit***
- ***Përpunimi digjital i të dhënave***
- ***Kërkimi në web/ internet, email-I dhe chat-i***
- ***Programimi dhe Algoritmika, Hyrje në programim dhe Excel-i***
- ***Prezantimi digjital (Komunikimi Funksional)***

## 8. Tematikat e TIK 8

### 8.1 Tematika I: Bota e kompjuterit (*hardware, software*)

#### 1.1 Origjinaliteti i dokumenteve digjitale

#### 1.2 Mbrojtja e informacionit me fjalëkalim

#### 1.3 Kompresimi i një bashkësie dokumentesh me programe të posaçme

#### 1.4 Instalimi i *Driver*-ave

#### 1.5 Regjistrimi i sekuecave të shkurtra filmike (videove)

### Rezultatet e të nxënit për Tematikën 1

#### Në fund të Tematikës 1, nxënësi/ja:

vlerëson rëndësinë e burimit të informacionit; koncepton vërtetësinë e informacionit të publikuar; vlerëson ruajtjen e autorësisë në një dokument; vlerëson rëndësinë e ruajtjes së informacionit me fjalëkalim; vlerëson domosdoshmërinë e kompresimit të skedarëve; identifikon programet e kompresimit; argumenton përparësitë e kompresimit të skedarëve; koncepton programin



---

---

komjuterik *Driver*; instalon *Driver*-at me anë të CD-së dhe nga interneti; regjistron sekuenat e shkurtra filmike nëpërmjet programit kompjuterik *Scratch*.

### **Aftësi që zhvillohen**

#### **Në fund të Tematikës 1, nxënësi/ja aftësohet:**

në marrjen e të dhënave nga disa burime në internet dhe vlerëson origjinalitetin, si dhe ruajtjen e autorësisë së një dokumenti; në ruajtjen me fjalëkalim të skedarit dhe mbrojtjen e fotografive në rrjetet sociale; në eksplorimin e mënyrave dhe programeve të kompresimit të skedarëve; në instalimin e *driver*-ave në kompjuter; në realizimin e projekteve duke përdorur programin kompjuterik *Scratch*.

## **8.2 Tematika II: Përpunimi digjital i të dhënave**

### **2.1 Programet e përpunimit të tekstit *online* dhe pa pagesë**

### **2.2 Krijimi i shablloneve të gatshme në *Microsoft Word***

### **2.3 Përpunimi i fotografive dhe grafikëve**

### **2.4 Prezantimi me *Smart Art***

### **2.5 Përpunimi i dokumenteve PDF duke përdorur *Adobe Acrobat Pro DC***

### **2.6 Veprimtari praktike: Grafiku i të dhënave**

## **Rezultatet e të nxënit për Tematikën 2**

### **Në fund të Tematikës 2, nxënësi/ja:**

koncepton programet e përpunimit të tekstit *online* dhe pa pagesë; koncepton programet edituese dhe ato për afishim e dokumenteve; koncepton dhe demonstroi shabllonet në *Microsoft Word*; përpunon imazhet dhe fotografitë nëpërmjet programit *Microsoft Word*; paraqet në mënyrë vizuale informacione të ndryshme duke përdorur grafikët *Smart Art*; përpunon dhe organizon dokumente në formatin PDF.

### **Aftësi që zhvillohen**

#### **Në fund të Tematikës 2, nxënësi/ja aftësohet:**

në eksplorimin e programeve të përpunimit të tekstit *online* dhe programeve për afishimin e dokumenteve; në krijimin e ftesave dhe kartolinave të ndryshme në programin *Microsoft Word*; në përpunimin e fotografive dhe grafikëve në *Microsoft Word*; në paraqitjen e informacionit nëpërmjet grafikëve *SmartArt*; në përpunimin e dokumenteve në PDF nëpërmjet programit *Adobe Acrobat Pro DC*; në zotërimin e elementeve të ndryshme të programit *Microsoft Word* për të paraqitur të dhëna dhe informacione.

---

---

### **8.3 Tematika III: Kërkimi në *Web/Internet, Email-i Dhe Chat-i***

#### **3.1 Prezantimi me internetin**

#### **3.2 *World Wide Web***

#### **3.3 Veprimtari praktike: Përdorimi i motorëve të kërkimit**

#### **3.4 Protokollet**

#### **3.5 *RSS dhe Podcast***

#### **3.6 Disa mënyra komunikimi: *email-i, chat-i dhe forumi***

#### **3.7 Punë praktike: Përdorimi i aplikacioneve të *Google-it***

### **Rezultatet e të nxënit për Tematikën 3**

#### **Në fund të Tematikës 3, nxënësi/ja:**

koncepton internetin dhe kanalet e transmetimit të informacionit; identifikon fushat e përdorimit të internetit; koncepton funksionimin e WWW; percepton dhe identifikon një *web browser*; aftësohet në përdorimin e motorëve të kërkimit; koncepton rrjetin kompjuterik; identifikon dhe koncepton funksionin e protokolleve në internet; njihet me konceptin RSS; koncepton skedarin *digjital* me media *Podcast*, si dhe abonohet në njoftimet RSS; vlerëson shërbimin e postës elektronike (*email-it*); dallon ndryshimin e komunikimit të *Chati-it* nga *email-i*; ruajnë rregullat e komunikimit në *Chat* dhe *email*; koncepton forumin në internet; aftësohet në përdorimin e aplikacionit *Google Groups* dhe *Google Docs*.

#### **Aftësi që zhvillohen**

#### **Në fund të Tematikës 3, nxënësi/ja aftësohet:**

në eksplorimin e shërbimeve të ndryshme që ofron interneti; në funksionimin e *web-it* sipas modelit *client-server* dhe kujdeset për informacionin që postohet në *web*; në prezantimet me protokollet dhe me rolin e tyre; në lajmet RSS për ndjekjen e informacioneve të dëshiruara; në identifikimin e rregullave të komunikimit dhe sigurisë në *email, Chat* dhe forume; në përdorimin e *Google Groups* dhe *Google Docs*.

### **8.4 Tematika IV: Hyrje Në Programim Dhe Excel-I**

#### **4.1 Formulatat dhe funksionet bazë të programit *Microsoft Excel*. Referencat relative, absolute dhe mikse.**

#### **4.2 Filtrimi i avancuar dhe importimi i të dhënave në *Excel***

#### **4.3 Punë praktike: Veprime me *Excel-in***

#### **4.4 Hyrje në *Visual Basic* dhe mjedisi i punës**

#### **4.5 Ndërtimi i një projekti**

**4.6 Variablat dhe përdorimi i tyre. Operatorët në *Visual Basic*****4.7 Disa funksione të rëndësishme në *Visual Basic*****4.8 Punë praktike: Veprime në *Visual Basic*****4.9 Integrimi i *Visual Basic* në *Excel*****4.10 Kontroll njohurish****Rezultatet e të nxënit për Tematikën 4****Në fund të Tematikës 4, nxënësi/ja:**

vlerëson rëndësinë e formulave dhe funksioneve bazë në *Excel*; koncepton dhe zbaton referencat relative, absolute dhe mikse; koncepton filtrimin e thjeshtë dhe të avancuar; mundëson importimin e të dhënave nga burime të ndryshme; koncepton gjuhën e programimit *Visual Basic*; familjarizohet me mjedisin e punës në *Visual Basic*; identifikon elementet e ndërfaqes IDE; ndërton formularët në *Visual Basic*; ekzekuton një aplikacion; deklaron dhe përdor variablat; identifikon operatorët dhe operandat në *Visual Basic*; koncepton funksionet dhe procedurat në *Visual Basic*; përdor funksionin *MsgBox* dhe *InputBox*; integron *Visual Basic* në *Excel*.

**Aftësi që zhvillohen****Në fund të Tematikës 4, nxënësi/ja aftësohet:**

në filtrimin e të dhënave dhe importimin e të dhënave në *Excel*; në njohjen e mjedisit të punës në *Visual Basic*; në ndërtimin dhe ekzekutimin e programeve në *Visual Basic*; në deklarimin e variablave dhe përdorimin e operatorëve dhe operandave në *Visual Basic*; në krijimin e funksioneve dhe procedurave në *Visual Basic* për të marrë dhe afishuar informacion përdoruesit; në ndërtimin dhe ekzekutimin e programeve të ndryshme në *Visual Basic*; në integrimin e *Visual Basic* në *Excel*.

**8.5 Tematika Prezantimi Digjital (Komunikimi Funkcional)****5.1 Shtimi i imazheve në prezantimin *PowerPoint*****5.2 Shtimi dhe stilizimi i tabelave dhe grafikëve në *PowerPoint*****5.3 Animimi i objekteve****5.4 Prezantimet në *Prezi*****5.5 Punë praktike: Prezantim me anë të *Prezit*, “Klasifikimi i kafshëve”****5.6 Projekt kurikular I: “Të jetojmë në një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm”****5.7 Projekt kurikular II: “Të jetojmë në një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm”.****Rezultatet e të nxënit për Tematikën 5****Në fund të Tematikës 5, nxënësi/ja:**

vendos imazhe në vizatim; ngjit dhe përpunon grafikët dhe fotografitë në faqet e prezantimit; krijon albume fotografike në *PowerPoint*; përdor dhe stilizon tabelat në prezantim; përdor mundësitë grafike në *PowerPoint* për të zmadhuar prezantimin e tekstit; përdor efektet vizuale dhe auditive; përdor *Prezi* si program prezantues.

### Aftësi që zhvillohen

#### Në fund të Tematikës 5, nxënësi/ja aftësohet:

në eksplorimin e mënyrave të ndryshme të shtimit të fotografive në *PowerPoint* dhe krijimin e albumeve fotografike; në krijimin, promovimin dhe paraqitjen e stilizimeve të ndryshme të tabelave dhe grafikëve në *PowerPoint*; në zbatimin, promovimin dhe paraqitjen e animimeve të ndryshme në *PowerPoint*; në përdorimin e programit prezantues *Prezi*, për të realizuar projekte të ndryshme; në krijimin, promovimin dhe paraqitjen e një prezantimi për një audiencë të gjerë.

### 9. Programi analitik

Tematikat	Nr.	Shpërndarja e përmbajtjes së lëndës		
		Shtator - Dhjetor (13 orë: 1.1 – 3.2)	Janar – Mars (12 orë: 3.3 – 4.7)	Prill – Qershor (10 orë: 4.8 -5.7)
Bota e kompjuterit Përpunimi digjital i të dhënave Kërkimi në Web/Internet, email-i dhe chat-i	1	1.1 Originaliteti i dokumenteve digjitale		
	2	1.2 Mbrojtja e informacionit me fjalëkalim		
	3	1.3 Kompresimi i një bashkësie dokumentesh me programe të posaçme		
	4	1.4 Instalimi i <i>Driver</i> -ave		
	5	1.5 Regjistrimi i sekuencave të shkurtra filmike (videove)		
	6	2.1 Programet e përpunimit të tekstit <i>online</i> dhe pa pagesë		
	7	2.2 Krijimi i shablloneve të gatshme në <i>Microsoft Word</i>		

	8	2.3 Përpunimi i fotografive dhe I grafikëve		
	9	2.4 Prezantimi në <i>SmartArt</i>		
	10	2.5 Përpunimi i dokumenteve PDF duke përdorur <i>Adobe Acrobat Pro DC</i>		
	11	2.6 Veprimtari Praktike: Grafiku i të dhënave		
	12	3.1 Prezantimi me internetin		
	13	3.2 <i>World Wide Web</i>		
Kërkimi në Ëeb/Internet, email-i dhe chat-i Hyrje në programim dhe Excel-i	14		3.3 Veprimtari Praktike: Përdorimi i motorëve të kërkimit	
	15		3.4 Protokollet	
	16		3.5 <i>RSS</i> dhe <i>Podcast</i>	
	17		3.6 Disa mënyra komunikimi: <i>email-i</i> , <i>chat-i</i> dhe forumi	
	18		3.7 Veprimtari praktike: Përdorimi i aplikacioneve të <i>Google</i>	
	19		4.1 Formulatat dhe funksionet bazë të programit <i>Microsoft Excel</i> . Referencat relative, absolute dhe mikse	

	20		4.2 Filtrimi i avancuar dhe importimi i të dhënave në <i>Excel</i>	
	21		4.3 Veprimtari Praktike	
	22		4.4 Hyrje në <i>Visual Basic</i> dhe mjedisi i punës	
	23		4.5 Ndërtimi i një projekti	
	24		4.6 Variablat dhe përdorimi i tyre. Operatorët në <i>Visual Basic</i>	
	25		4.7 Disa funksione të rëndësishme në <i>Visual Basic</i>	
Hyrje në programim dhe <i>Excel</i> -i Prezantimi digjital (komunikimi funksional)	26			4.8 Veprimtari praktike: Shembuj të ndryshëm në <i>Visual Basic</i>
	27			4.9 Integrimi i <i>Visual Basic</i> në <i>Excel</i>
	28			4.10 Kontroll njohurish
	29			5.1 Shtimi i imazheve në

			prezantimin <i>PowerPoint</i>
30			5.2 Shtimi dhe stilizimi i tabelave dhe i grafikëve në <i>PowerPoint</i>
31			5.3 Animimi i objekteve
32			5.4 Prezantimi në <i>Prezi</i>
33			5.5 Punë Praktike: Prezantim me anë të <i>Prezit</i> , “Klasifikimi i kafshëve”
34			5.6 Tema: “Të jetojmë në një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm”
35			5.7 Tema: ‘Të jetojmë në një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm’

**10. PLANIFIKIMI 3 MUJOR****Planifikimi 3-mujor (shtator – dhjetor)**

Nr	Tematika	Temat mësimore	Situata e parashikuar e të nxënësve	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet
1	Bota e kompjuterit	1.1 Originaliteti i dokumenteve digjitale	Shumica prej jush kërkon informacione në faqe të ndryshme dhe më pas, pasi i kopjoni, vendosni emrin tuaj në fund të dokumentit. Sa i vërtetë dhe i saktë është ky informacion? Si duhet vepruar?	Mësimdhënie e drejtpërdrejtë	Vlerësim me pikë për punën krijuese dhe origjinalitetin e materialeve.	Kompjuteri dhe interneti
2	Bota e kompjuterit	1.2 Mbrojtja e informacionit me fjalëkalim	Prindërit e mi kanë zyrë kontabiliteti dhe mbajnë bilancet e bizneseve të ndryshme duke përdorur Microsoft <i>Excel</i> -in. Shpeshherë, atyre u duhet ta mbrojnë këtë informacion. Çfarë duhet bërë? Si realizohet ruajtja e një dokumenti me fjalëkalim?	Punë krijuese individuale	Vlerësim në formë motivimi, evidentimi dhe kultivimi i prirjeve.	Kompjuteri
3	Bota e	1.3 Kompresimi i	Skedarët digjitalë	Punë	Vlerësim në	Librat dhe



	kompjuterit	një bashkësie dokumentesh me programe të posaçme	janë të shumtë në një kompjuter dhe për t'i zhvendosur ata në një kompjuter tjetër duhen orë të tëra. Ndodh që procesi i zhvendosjes të ndërpritet disa herë, sepse rastis të kemi skedarë digjitalë të dëmtuar që pengojnë zhvendosjen. Çfarë duhet të bëjmë?	individuale	formë edukimi, evidentimi i problematikave dhe zgjidhja e tyre.	interneti
4	Bota e kompjuterit	1.4 Instalimi i Driver-ave	Printeri i ri i sapolidhur me kompjuterin tuaj ndizet, por nuk printon. Si është e mundur? Pse Windows-i nuk e njeh atë automatikisht? Në kutinë e tij të ambalazhit gjendet një disk me mbishkrimin: <i>Driver...</i> Çfarë do jetë ky? Eja ta shohim!	Punë praktike individuale	Vlerësim në formë motivimi, evidentimi i prirjeve.	Fizika, Elektronika, Gjuhët e komunikimit
5	Bota e kompjuterit	1.5 Regjistrimi i sekuencave të shkurtra filmike	Diskutoni në klasë se me çfarë programesh	Punë praktike	Vlerësim në formë motivimi,	Kompjuteri dhe interneti

		(videove)	kompjuterike realizohen videot.		evidentimi i prirjeve.	
6	Përpunimi digjital i të dhënave	2.1 Programet e përpunimit të tekstit online dhe pa pagesë	Çfarë dini për aplikacionet online? Diskutoni duke përmendur disa prej tyre.	Organizimi në klasë ose në ambientet e shkollës për punë praktike në grup.	Vlerësim për punën në grup dhe argumentet që sjellin në diskutim.	Kompjuteri, kablo, <i>router</i> dhe interneti
7	Përpunimi digjital i të dhënave	2.2 Krijimi i shabllojeve të gatshme në Microsoft Word	Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të përcaktojnë aktivitetet e klasës për muajin mars. A dimë të ndërtojmë një kalendar?	Bashkëpunim me mësuesin, mësojmë vetë mësimin e ri.	vlerësimi fokusohet në mënyrën e të nxënësve të secilit nxënës.	Kompjuteri dhe interneti
8	Përpunimi digjital i të dhënave	2.3 Përpunimi i fotografive dhe grafikëve	Shpesh, dokumente të ndryshme të <i>Word</i> -it shoqërohen me fotografi, apo imazhe që e ilustron informacionin. Diskutoni si mund të shtojmë fotografi të ndryshme, brenda një <i>teksti në Word</i> .	Diskutime dhe argumente, zgjerim i koncepteve bazë.	Fokusohet në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve/shoqeve.	Kompjuteri, librat dhe interneti.
9	Përpunimi digjital i të dhënave	2.4 Prezantimi në SmartArt	A keni menduar ndonjëherë se si mund të bëjmë orarin e mësimeve?	Punë praktike në grup	Vlerësim në formë motivimi, evidentimi dhe kultivimi i prirjeve	Kompjuteri dhe interneti

10	Përpunimi digjital i të dhënave	2.5 Përpunimi i dokumenteve PDF duke përdorur <i>Adobe Acrobat Pro DC</i>	Shpeshherë na duhet të ndërhyjmë dhe të përpunojmë informacionin e një dokumenti në formatin PDF. Shumë përdorues të kompjuterit e kanë të vështirë të ndërhyjnë brenda tij. Çfarë duhet bërë?	Punë krijuese, kultivimi i prirjeve.	Nxënësit vlerësohen për idenë dhe mënyrën se si e përcjellin atë në materialin e punuar prej tyre.	Kompjuteri dhe interneti
11	Përpunimi digjital i të dhënave	2.6 Veprimtari Praktike: Grafiku i të dhënave	Mbledhim të dhëna në klasë dhe më pas i paraqisim ato duke përdorur grafikët Chart dhe SmartArt	Praktikë dhe krijimtari.	Vlerësim në formë motivimi, evidentimi dhe kultivimi i prirjeve	Kompjuteri dhe interneti
12	Kërkimi në <i>Web/Internet-i, email-i, chat-i</i>	3.1 prezantimi me internetin	Çfarë dini mbi internetin? Përse e përdorim atë? Çfarë të mirash kemi prej tij?	Punë individuale, hulumtim.	Vlerësim në formë motivimi, evidentimi dhe kultivimi i prirjeve.	Kompjuteri dhe interneti
13	Kërkimi në <i>Web/Internet, email-i, chat-i</i>	3.2 <i>World Wide Web</i>	Flisni mbi <i>browser</i> -at që njihni, çfarë dini rreth tyre?	Punë praktike individuale dhe në grup.	Vlerësim në formë motivimi, evidentimi dhe kultivimi i prirjeve.	Kompjuteri, libri dhe interneti

**Planifikimi 3-Mujor (Janar - Mars)**

<b>Nr.</b>	<b>Tematika</b>	<b>Temat mësimore</b>	<b>Situata e parashikuar e të nxënësve</b>	<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b>	<b>Vlerësimi</b>	<b>Burimet</b>
1	Kërkimi në <i>Web/Internet, email-i, chat-i</i>	3.3.Veprimtari Praktike: Përdorimi i motorëve të kërkimit	Çfarë është një motor kërkimi? Si i përdorim ato?	Stuhi mendimesh dhe trajtim praktik i teorisë së thelluar.	Vlerësim në bazë të punës praktike që nxënësit kanë realizuar.	Kompjuteri dhe interneti
2	Kërkimi në <i>Web/Internet, email-i, chat-i</i>	3.4.Protokollet	Si dërgohen të dhënat nga një kompjuter në një tjetër? Si transferohet informacioni? Cila është rëndësia e protokolleve në komunikimin në internet?	Praktikojmë njohuritë, punë individuale.	Vlerësim për punën praktike, evidentimi dhe kultivimi i prirjeve.	Kompjuteri, interneti
3	Kërkimi në <i>Web/Internet, email-i, chat-i</i>	3.5 RSS dhe Podcast	Nëse ju interesojnë informacione nga interneti, si: sporti, muzika, filma,	Punë krijuese individuale.	Vlerësim i punës së secilit/ës nxënësi/e.	Kompjuteri dhe interneti

			këngë, lojëra etj., a dini si veprohet për t'u abonuar në këto faqe?			
4	Kërkimi në <i>Web/Internet, email-i, chat-i</i>	3.6 Disa mënyra komunikimi: <i>email-i, chat-i</i> dhe forumi	Flisni mbi adresën postare dhe adresën elektronike. Cilat janë mënyrat e komunikimit në internet? A keni dëgjuar për <i>forumet</i> ?	Stuhi mendimesh, punë krijuese individuale.	Vlerësim në formë individuale me realizimin e detyrave përkatëse.	Revista, kompjuteri, interneti
5	Kërkimi në <i>Web/Internet, email-i, chat-i</i>	3.7 Veprimtari Praktike: Përdorimi i aplikacioneve të <i>Google</i>	Përdorimi i aplikacionit <i>Google Groups; dhe Google Docs.</i> , të cilët shërbejnë për marrjen e të dhënave nga përdoruesi.	Vëzhgim i punës së nxënësve dhe diskutim në klasë.	Vlerësim me pikë.	Programi, kompjuteri
6	Hyrje në programim dhe <i>Excel-i</i>	4.1 Formulatat dhe funksionet bazë të programit	Nga e kuptojmë që numri 5 në qelizën A3 mbart një	Teori dhe praktikë	Mësuesi vë në garë nxënësit për të evidentuar ata që kanë më	Programi dhe kompjuteri

		<i>Microsoft Excel.</i> Referencat relative, absolute dhe mikse	formulë?		tepër prirje.	
7	Hyrje në programim dhe <i>Excel</i> -i	4.2 Filtrimi i avancuar dhe importimi i të dhënave në <i>Excel</i>	Si mund të gjejmë shpejt dhe saktë informacionin e duhur brenda një tabele? Përse duhet të importojmë të dhëna në <i>Excel</i> ?	Punë praktike individuale.	Vlerësim në formë motivimi, evidentimi dhe kultivimi i prirjeve.	Imazhe, kompjuteri, interneti
8	Hyrje në programim dhe <i>Excel</i> -i	4.3 Veprimtari Praktike	Veprimtari praktike në përdorimin e formualeve në <i>Excel</i> .	Punë në grupe.	Vlerësim me pikë.	Kompjuteri dhe interneti
9	Hyrje në programim dhe <i>Excel</i> -i	4.4 Hyrje në <i>Visual Basic</i> dhe mjedisi i punës	Keni dëgjuar për aplikacionet? Po për gjuhët e programimit?	Punë në grupe.	Mësuesi evidenton prirjet e nxënësve dhe i motivon ata.	Kompjuteri
10	Hyrje në programim dhe <i>Excel</i> -i	4.5 Ndërtimi i një projekti	Realizimi formave dhe i butonave.	Punë krijuese individuale	Vlerësim në formë motivimi, evidentimi dhe	Kompjuteri dhe interneti

					kultivimi i prirjeve	
11	Hyrje në programim dhe <i>Excel</i> -i	4.6 Variablat dhe përdorimi i tyre. Operatorët në <i>Visual Basic</i>	Variabli është emri i një zone të kujtesës së kompjuterit ku ruajmë informacion. Si zgjidhen dhe deklarohen variablat? Cilat janë tipat e të dhënave që përdoren në <i>Visual Basic</i> ?	Punë në grup, vëzhgim dhe krahasim i gjuhëve të programimit.	Mësuesi vlerëson nxënësin për njohuritë që ai ka për gjuhët e programimit që ai njeh dhe diskutimet që bën në klasë për <i>Variablat</i> në <i>Visual Basic</i> .	Programi, libri, kompjuteri dhe interneti
12	Hyrje në programim dhe <i>Excel</i> -i	4.7 Disa funksione të rëndësishme në <i>Visual Basic</i>	Çfarë janë funksinet dhe procedurat?	Punë krijuese individuale	Mësuesi vlerëson nxënësit në bazë të bashkëbisedimit duke evidentuar kapacitetin e tyre dhe paqartësitë që kanë.	Matematika kompjuteri, interneti

## Planifikimi 3-Mujor (Prill – Qeshor )

Nr.	Tematika	Temat mësimore	Situata e parashikuar e të nxënësve	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet
1	Hyrje në programim dhe <i>Excel</i> -i	4.8 Veprimtari praktike: Shembuj të ndryshëm në <i>Visual Basic</i>	Praktikimi i shembujve të ndryshëm në VB	Praktikojmë njohuritë dhe konceptet e trajtuara në tematikë.	Mësuesi vëzhgon ecurinë e punëve praktike dhe evidenton nxënësit që kanë prirje.	Kompjuteri, programi dhe interneti
2	Hyrje në programim dhe <i>Excel</i> -i	4.9 Integrimi i <i>Visual Basic</i> në <i>Excel</i>	Për të llogaritur vlera të caktuara në <i>Excel</i> , duhet të shkruhen formulat në çdo qelizë që do të përdoren, dhe kjo e bën të vështirë punën me <i>Excel</i> -in. Gjithashtu është i vështirë modifikimi i sigurt dhe i besueshëm i faqeve të <i>Excel</i> -it kur përdoren nga disa përdorues. <i>Visual Basic Editor</i> është një program në <i>Excel</i> që na lejon të	Punë krijuese individuale	Vlerësimi në formë motivimi. Vlerësohen punimet më të mira.	Kompjuteri dhe interneti



			komunikojmë me të.			
3	Hyrje në programim dhe <i>Excel</i> -i	4.10 Kontroll njohurish	Integrimi i <i>VBA</i> -së në <i>Excel</i> .	Punë krijuese individuale	Mësuesi vlerëson nxënësit në bazë të ecurisë së deritanishme. Ai/ajo vë në garë nxënësit që kanë më tepër prirje për gjuhët e programimit, në mënyrë që të evidentojë prirjet dhe të plotësojë mangësitë.	Interneti dhe kompjuteri
4	Prezantimi digjital (Komunikimi funksional)	5.1 Shtimi i imazheve në prezantimin <i>PowerPoint</i>	Nxënësit, të ndarë në grupe, prezantojnë në klasë projektin e tyre me temë: "Tirana, kryeqyteti i Shqipërisë". Sa e rëndësishme është vendosja e imazheve gjatë një	Punë individuale si dhe bashkëpunim me mësuesin	Vlerësimi në formë motivimi, evidentimi dhe kultivimi i prirjeve.	Kompjuteri dhe libri

			prezantimi?			
5	Prezantimi digjital (Komunikimi funksional)	5.2 Shtimi dhe stilizimi i tabelave dhe i grafikëve në <i>PowerPoint</i>	Shpesh, gjatë prezantimeve na duhet të vendosim informacione që përmbajnë të dhëna numerike. Si e realizojmë këtë?	Punë individuale.	Vlerësim për konceptet dhe argumentet që trajtohen.	Libri dhe kompjuteri
6	Prezantimi digjital (Komunikimi funksional)	5.3 Animimi i objekteve	Çfarë elementesh futen në <i>PowerPoint</i> për të tërhequr vëmendjen e audiencës? Si realizohet lëvizja e objekteve të ndryshme?	Ndërthurje e teorisë me jetën reale.	Vlerësimi në formë motivimi, evidentimi dhe kultivimi i prirjeve.	Libri dhe kompjuteri
7	Prezantimi digjital (Komunikimi funksional)	5.4 Prezantimi në <i>Prezi</i>	A keni dëgjuar për prezantimet online? Si shpërndahen ato në rrjetet sociale?	Ndërthurje e teorisë me praktikën, punë individuale në kompjuter.	Vlerësimi do të bazohet në pyetjet teorike dhe përgjigjen saktë të pyetjeve.	Libri dhe kompjuteri
8	Prezantimi digjital (Komunikimi funksional)	5.5 Punë Praktike: Prezantim me	Demonstrimi i prezantimeve në klasë,	Ndërthurje e teorisë me praktikën,	Mësuesi/ja pyet nxënësit si e	Libri dhe kompjuteri

		anë të <i>Prezit</i> , 'Klasifikimi i kafshëve'	krahasimi dhe analizimi i formës së prezantimit dhe efektshmërinë e tij lidhur me temën e përcaktuar	punë individuale ose në grupe të vogla në kompjuter.	konceptojnë këtë projekt dhe u jep detyrë shtëpie në grup.	
9	Prezantimi digjital (Komunikimi funksional)	5.6 Tema: 'Të jetojmë në një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm'	Punë në grupe mbi mënyrat e vjeljes së informacioneve të duhura, mbi llojin e informacionit dhe risitë që duhen përdorur për një prezantim sa më mbresëlënës.	Ndërthurje e teorisë me praktikën, punë individuale ose në grupe të voglanë kompjuter.	Mësuesi/ja pyet nxënësit si e konceptojnë këtë projekt dhe u jep detyrë shtëpie në grup.	Libri dhe kompjuteri
10	Prezantimi digjital (Komunikimi funksional)	5.7 Tema: 'Të jetojmë në një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm'	Finalizim i projektit me prezantim të materialit.	Shpjegim i drejtpërdrejtë	Bashkëbisedim	Libri dhe programi në kompjuter

## 10. Planifikimi ditor (ditari)

<b>Fusha: Bota e kompjuterit</b>	<b>Lënda: TIK</b>	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Tema mësimore:</b> 1.1 Origjinaliteti i dokumenteve digjitale		<b>Situata e të nxënit:</b> <i>Shumica prej jush kërkon informacione në faqe të ndryshme dhe më pas, pasi i kopjoni, vendosni emrin tuaj në fund të dokumentit. Sa i vërtetë dhe i saktë është ky informacion? Si duhet vepruar?</i>	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit;</li> <li>kompetenca digjitale.</li> </ul>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>vlerëson rëndësinë e burimit të informacionit;</li> <li>koncepton vërtetësinë e informacionit të publikuar;</li> <li>vlerëson ruajtjen e autorësisë në një dokument.</li> </ul>		<b>Fjalët kyç:</b> Dokumenti origjinal digjital, vërtetësia e një dokumenti, ruajtja e autorësisë.	
<b>Burimet:</b> kompjuteri dhe interneti.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> Gjuhët dhe komunikimi etj.	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> ndërlihdje e teorisë me praktikën, punë krijuese.			
<b>Organizimi i orës së mësimi</b> Mësuesi/ja jep si detyrë të hartojnë një ese me temë të lirë. Temës duhet t'i bashkëngjisim një foto të marrë nga interneti ose të fotografuar nga vetë nxënësi. Mësuesi/ja vlerësojnë punimin dhe krijimin më origjinal.			
<b>Vlerësimi:</b> vlerësim me pikë për punën krijuese dhe origjinalitetin e materialeve.			
<b>Detyrat dhe puna e pavarur:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>Sa i rëndësishëm është burimi i informacionit?</li> <li>Përmendni disa raste të vërtetësisë së informacionit të marrë në internet.</li> <li>Çfarë kuptoni me termin "copyright"?</li> </ol> <b>Detyrë:</b> Merrni informacione të duhura nga interneti për lëndët e shkollës, duke u konsultuar me mësuesin/en ose prindërit.			

## 11. Planifikimi ditor (ditari)

Fusha: Bota e kompjuterit	Lënda: TIK	Shkalla: V	Klasa: VIII
<b>Tema mësimore:</b> 1.2. Mbrojtja e informacionit me fjalëkalim.		<b>Situata e të nxënit:</b> <i>Prindërit e mi kanë zyrë kontabiliteti dhe mbajnë bilancet e bizneseve të ndryshme duke përdorur Microsoft Excel-in. Shpeshherë, atyre u duhet ta mbrojnë këtë informacion. Çfarë duhet bërë? Si realizohet ruajtja e një dokumenti me fjalëkalim?</i>	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• kompetenca e të nxënit;</li> <li>• kompetenca digjitale.</li> </ul>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• vlerëson rëndësinë e mbrojtjes së skedarëve me fjalëkalim;</li> <li>• zgjedh fjalëkalimin e duhur;</li> <li>• mbron fotografitë personale në rrjete sociale.</li> </ul>		<b>Fjalët kyç:</b> <i>passWord.</i>	
<b>Burimet:</b> kompjuteri dhe interneti.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> Gjuhët dhe komunikimi.	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> punë praktike individuale.			
<b>Organizimi i orës së mësimt</b> Provoni të ndryshoni fjalëkalimin e telefonit tuaj personal. Provoni të bëni të njëjtën gjë me kompjuterin tuaj ose një dokument tuajin.			
<b>Vlerësimi:</b> vlerësim në formë motivimi, evidentimi dhe kultivimi i prirejeve.			
<b>Detyrat dhe puna e pavarur:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Pse është i rëndësishëm ruajtja e një informacioni me fjalëkalim?</li> <li>2. Jepni raste të fjalëkalimeve të ndryshme duke argumentuar nëse është fjalëkalim i butë, mesatar apo i fortë.</li> <li>3. Hapni një skedar në <i>Word</i> dhe vendosini një fjalëkalim.</li> <li>4. Rregulloni mjedisin e sigurisë nëpërmjet opsioneve të <i>Privacy Setting</i> në rrjetin social <i>Facebook</i>.</li> </ol>			

## Planifikimi ditor (ditari)

Fusha: Bota e kompjuterit	Lënda: TIK	Shkalla: V	Klasa: VIII
<b>Tema mësimore:</b> 1.3 Kompresimi i një bashkësie dokumentesh me programe të posaçme	<b>Situata e të nxënit:</b> Skedarët digjitalë janë të shumtë në një kompjuter dhe për t'i zhvendosur ata në një kompjuter tjetër duhen orë të tëra. Ndodh që procesi i zhvendosjes të ndërpritet disa herë, sepse rastis të kemi skedarë digjitalë të dëmtuar që pengojnë zhvendosjen. Çfarë duhet të bëjmë?		
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>kompetenca digjitale;</li> <li>kompetenca personale.</li> </ul>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>vlërëson domosdoshmërinë e kompresimit të skedarëve;</li> <li>identifikon programet e kompresimit;</li> <li>argumenton përparësitë e kompresimit të skedarëve.</li> </ul>	<b>Fjalët kyç:</b> kompresim.		
<b>Burimet:</b> Kompjuteri dhe librat.	<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> Gjuhët e komunikimit, Matematikën etj.		
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> punë individuale.			
<b>Organizimi i orës së mësimin</b> Në laboratorin e informatikës gruponi fotografitë e bëra në ekskursionin e fundit dhe kompresojini me një nga mënyrat e treguara në tekst. Më pas, këto fotografi nisjani shokëve dhe shoqeve të klasës me <i>email</i> .			
<b>Vlerësimi:</b> vlerësim në formë edukimi, evidentimi i problematikave dhe zgjidhja e tyre.			
<b>Detyrat dhe puna e pavarur:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>Përse është i rëndësishëm kompresimi i skedarëve?</li> <li>Tregoni mënyrat e kompresimit të skedarëve.</li> <li>Diskutoni përparësitë e kompresimit të të dhënave.</li> </ol>			

## Planifikimi ditor (ditari)

Fusha: Bota e kompjuterit	Lënda: TIK	Shkalla: V	Klasa: VIII
<b>Tema mësimore:</b> 1.4 Instalimi i <i>Driver</i> -ave		<b>Situata e të nxënit:</b> <i>Printeri i ri i sapolidhur me kompjuterin tuaj ndizet, por nuk printon. Si është e mundur? Pse Windows-i nuk e njeh atë automatikisht? Në kutinë e tij të ambalazhit gjendet një disk me mbishkrimin: Driver... Çfarë do jetë ky? Eja ta shohim!</i>	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>kompetenca digjitale;</li> <li>kompetenca e të nxënit;</li> <li>kompetenca personale.</li> </ul>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>koncepton programin kompjuterik <i>Driver</i>;</li> <li>instalon <i>Driver</i>-at me anë të CD-së;</li> <li>instalon <i>Driver</i>-at nga interneti.</li> </ul>		<b>Fjalët kyç:</b> Driver.	
<b>Burimet:</b> kompjuteri, CD dhe interneti.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> Fizikën, Gjuhët e komunikimit etj.	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> punë praktike individuale.			
<b>Organizimi i orës së mësimi</b> Lidhni kamerën me kompjuterin tuaj dhe shikoni nëse <i>Windows</i> -i e njeh atë automatikisht. Në të kundërt instalojeni nga CD-ja që ndodhet bashkë me të në kutinë e ambalazhit.			
<b>Vlerësimi:</b> vlerësim në formë motivimi, evidentimi i prirjeve.			
<b>Detyrat dhe puna e pavarur:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>Çfarë kuptoni me fjalën <i>Driver</i>?</li> <li>Si realizohet instalimi i një <i>Driver</i>-i me anë të CD-së?</li> <li>Si kryhet instalimi i një <i>Driver</i>-i nga interneti?</li> </ol>			

**Planifikimi ditor (ditari)**

<b>Fusha: Bota e kompjuterit</b>	<b>Lënda: TIK</b>	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Tema mësimore:</b> 1.5 Regjistrimi i sekuecave të shkurtra filmike (videove)		<b>Situata e të nxënit:</b> Diskutoni në klasë se me çfarë programesh kompjuterike realizohen videot.	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>kompetenca digjitale;</i></li> <li>• <i>kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit;</i></li> <li>• <i>kompetenca personale.</i></li> </ul>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>identifikon komandat kryesore të programit kompjuterik Scratch;</i></li> <li>• <i>realizon një projekt me anë të komandave kyç të programit kompjuterik Scratch;</i></li> <li>• <i>realizon dhe ruan sekuenca filmike nëpërmjet programit kompjuterik Scratch.</i></li> </ul>		<b>Fjalët kyç:</b> sekuenca filmike, skedar video.	
<b>Burimet:</b> kompjuteri dhe interneti.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> Gjuhët e komunikimit, Artin etj.	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> bashkëpunim mes mësuesit dhe nxënësve.			
<b>Organizimi i orës së mësimin</b> Mësuesi organizon klasën në punë praktike: Ndjekim hapat e trajtuara në mësimin e ditës dhe mësojmë mësimin në formë praktike. Mësuesi i ngarkon të njëjtën detyrë në shtëpi.			
<b>Vlerësimi:</b> vrojtimit e mësuesit, lista e kontrollit.			
<b>Detyrat dhe puna e pavarur:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Instaloni programin <i>Scratch</i> në kompjuter.</li> <li>2. Diskutoni në klasë se çfarë mund të realizoni me këtë program.</li> <li>3. Përmendni komandat kryesore të këtij programi dhe flisni për shërbimin që ofron secila komandë.</li> <li>4. Realizoni të ndarë me grupe një miniprojekt si shembulli në libër.</li> <li>5. Ruajeni videon dhe shpërndajeni te shokët/shoqet e klasës.</li> </ol>			



## Planifikimi ditor (ditari)

<b>Fusha: Përpunimi digjital i të dhënave</b>	<b>Lënda: TIK</b>	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Tema mësimore:</b> 2.1 Programet e përpunimit të tekstit <i>online</i> dhe pa pagesë		<b>Situata e të nxënit:</b> Çfarë dini për aplikacionet <i>online</i> ? Diskutoni duke përmendur disa prej tyre.	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin;</li> <li>kompetenca digjitale.</li> </ul>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>identifikon programet e përpunimit të tekstit <i>online</i>;</li> <li>identifikon programet edituese dhe ato të afishimit të dokumenteve.</li> </ul>		<b>Fjalët kyç:</b> aplikacion <i>online</i> .	
<b>Burimet:</b> kompjuteri dhe interneti.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> Gjuhët e komunikimit, Fizikën, Ekonominë etj.	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> punë paktike.			
<b>Organizimi i orës së mësimin</b> Pasi mësuesi shpjegon mësimin e ri dhe nxënësit tashmë dijnë se cilat janë programet e përpunimit <i>online</i> , u sugjerohet të zhvillojnë një projekt të lëndëve të tjera (Letërsi, Gjeografi etj) në mënyrë që jo vetëm të përpunojë tekste por edhe figura.			
<b>Vlerësimi:</b> vlerësim për punën krijuese dhe praktikiteti në klasë.			
<b>Detyrat dhe puna e pavarur:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>Çfarë quajmë programe të përpunimit të tekstit <i>online</i>?</li> <li>Kërkoni në internet për shembuj të programeve të përpunimit të tekstit <i>online</i> dhe pa pagesë.</li> <li>Cili është ndryshimi midis programe edituese dhe programeve që shërbejnë për afishimin e dokumenteve?</li> <li>Instaloni programin <i>Free File Viewer</i> dhe afishoni informacione në formatin <i>DOCX</i>, <i>XLSX</i> dhe <i>PDF</i>.</li> </ol>			

## Planifikimi ditor (ditari)

<b>Fusha: Përpunimi digjital i të dhënave</b>	<b>Lënda:</b> TIK	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Tema mësimore:</b> 2.2 Krijimi i shablloneve të gatshme në Microsoft Word		<b>Situata e të nxënësve:</b> <i>Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të përcaktojnë aktivitetet e klasës për muajin mars. A dimë të ndërtojmë një kalendar?</i>	
<b>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyç:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>kompetenca për të nxënë;</i></li> <li>• <i>kompetenca personale;</i></li> <li>• <i>kompetenca digjitale.</i></li> </ul>			
<b>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>koncepton shabllonet në Microsoft Word;</i></li> <li>• <i>demonstron një shabllon të gatshëm.</i></li> </ul>		<b>Fjalët kyç:</b> shabllon, situatë.	
<b>Burimet:</b> kompjuteri dhe interneti.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> Matematikën, Gjuhët e komunikimit etj.	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> bashkëpunim me mësuesin, mësojmë vetë mësimin e ri.			
<b>Organizimi i orës së mësimin</b> Ndjekim hapat në libër, tek mësimi i ditës (faqe 22) dhe përpqemi të mësojmë në formë autodidakte.			
<b>Vlerësimi:</b> vlerësimi fokusohet në mënyrën e të nxënësve të secilit nxënës.			
<b>Detyrat dhe puna e pavarur:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Krijoni një kartolinë në të cilën të uroni shokun ose shoqen tuaj më të ngushtë.</li> <li>2. Krijoni një ftesë në të cilën të ftoni të gjithë miqtë për ditëlindjen tuaj. Specifikoni se çfarë informacioni duhet të përfshihet në të.</li> <li>3. Krijoni një kalendar në të cilin të specifikoni detyrat tuaja për të gjithë muajin.</li> </ol>			

## Planifikimi ditor (ditari)

Fusha: Përpunimi digjital i të dhënave	Lënda: TIK	Shkalla: V	Klasa: VIII
<b>Tema mësimore:</b> 2.3 Përpunimi i fotografive dhe grafikëve		<b>Situata e të nxënit:</b> <i>Shpesh, dokumente të ndryshme të Word-it shoqërohen me fotografi, apo imazhe që e ilustrjnë informacionin. Diskutoni si mund të shtojmë fotografi të ndryshme, brenda një teksti në Word.</i>	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin;</li> <li>kompetenca personale; kompetenca digjitale.</li> </ul>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>shton fotografitë brenda një dokumenti Word;</li> <li>identifikon mjetet për përpunimin e fotografive;</li> <li>paraqet të dhënat në formë grafike.</li> </ul>		<b>Fjalët kyç:</b> fotografi, imazhe, përpunim i fotografisë.	
<b>Burimet:</b> kompjuteri dhe interneti.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> Shkencat e natyrës, Gjuhët e komunikimit, etj.	
<b>Organizimi i orës së mësimin:</b> Merrni nga interneti disa fotografi dhe përpunojini ato në forma të ndryshme duke praktikuar të gjitha komandat që të ofron programi. Zgjidhni komandën e përpunimit që ju pëlqen më shumë dhe në të njëjtën mënyrë veproni dhe me një fotografi tuajën.			
<b>Vlerësimi:</b> fokusohet në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve/shoqeve.			
<b>Detyrat dhe puna e pavarur:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>Kërkoni në internet një fotografi që shfaq sportin tuaj të preferuar.</li> <li>Shtojeni këtë fotografi në dokumentin <i>Word</i>.</li> <li>Aplikoni formatime të ndryshme mbi fotografinë duke shkruar përbri fotografisë ndryshimet e kryera.</li> <li>Ndërtoni një grafik që tregon se sa shpesh e luani këtë sport sipas muajve të vitit. Zgjidhni grafikun që i përshtatet më mirë këtyre të dhënave.</li> <li>Shoqëroni grafikun dhe fotografinë me një tekst të shkurtër. I poziciononi në mënyrë të qartë në dokumentin tuaj.</li> <li>Ruajeni dokumentin e krijuar në kompjuterin tuaj.</li> </ol>			

## Planifikimi ditor (ditari)

Fusha: Përpunimi digjital i të dhënave	Lënda: TIK	Shkalla: V	Klasa: VIII
<b>Tema mësimore:</b> 2.4 Prezantimi me SmartArt		<b>Situata e të nxënit:</b> A keni menduar ndonjëherë se si mund të bëjmë orarin e mësimëve?	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>kompetenca për të nxënë;</i></li> <li>• <i>kompetenca personale;</i></li> <li>• <i>kompetenca digjitale.</i></li> </ul>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• koncepton grafikun <i>SmartArt</i>;</li> <li>• shton grafikun brenda një dokumenti;</li> <li>• modifikon elemente të ndryshme të grafikut <i>SmartArt</i>.</li> </ul>		<b>Fjalët kyç:</b> grafiku <i>SmartArt</i> .	
<b>Burimet:</b> kompjuteri dhe interneti.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> Shkencat e natyrës etj.	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> Punë praktike në grup.			
<b>Organizimi i orës së mësimin</b> Mësuesi organizon klasën në punë grupi. Duke u bazuar në mësimin e ri, nxënësit nisin një projekt model sipas hapave që parashtohen në libër. Nxënësit duhet të përshkruajnë rrugën që ndoqën deri në fund të projektit.			
<b>Vlerësimi:</b> vlerësim dhe diskutim që nxënësit/et bëjnë për punën e tyre dhe të shokëve/shoqeve.			
<b>Detyrat dhe puna e pavarur:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ndërtoni një grafik <i>SmartArt</i>, me të cilën të paraqisni aktivitetin tuaj ditor.</li> <li>2. Ndërtoni një grafik <i>SmartArt</i> për të paraqitur trungun familjar. Shpjegoni se cilin tip grafiku <i>SmartArt</i> do të përdorni me qëllim që të paraqitet më mirë informacioni i kërkuar.</li> <li>3. Shpjegoni ndryshimin midis grafikëve. Jepni shembull se kur mund të përdoren grafikët në libër.</li> </ol>			

## Planifikimi ditor (ditari)

Fusha: Përpunimi digjital i të dhënave	Lënda: TIK	Shkalla: V	Klasa: VIII
<b>Tema mësimore</b> 2.5 Përpunimi i dokumenteve PDF duke përdorur <i>Adobe Acrobat Pro DC</i>		<b>Situata e të nxënësve:</b> Shpeshherë na duhet të ndërhyjmë dhe të përpunojmë informacionin e një dokumenti në formatin <i>PDF</i> . Shumë përdorues të kompjuterit e kanë të vështirë të ndërhyjnë brenda tij. Çfarë duhet bërë?	
<b>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyç:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>kompetenca për të nxënë;</i></li> <li>• <i>kompetenca digjitale.</i></li> </ul>			
<b>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>prezantohet me programin Adobe Acrobat Pro DC;</i></li> <li>• <i>përpunon tekstin në një dokument PDF;</i></li> <li>• <i>përpunon fotografitë në një dokument PDF.</i></li> </ul>		<b>Fjalët kyç:</b> formati PDF	
<b>Burimet:</b> fotografi, kompjuteri dhe interneti.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> Shoqërinë dhe mjedisin, Gjuhët e komunikimit.	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> punë krijuese, kultivimi i prirjeve.			
<b>Organizimi i orës së mësimin</b> Gjeni në <i>Google</i> një material çfarëdo dhe përpuni të bëni disa ndryshime në mënyrë që ta përshtasni me idetë dhe krijimtarinë tuaj. Përveç tekstit, përfshini në material figura dhe grafikë të ndryshëm. Më pas ruajeni dokumentin dhe rimërojeni duke përdorur komandën e saktë.			
<b>Vlerësimi:</b> nxënësit vlerësohen për idenë dhe mënyrën se si e përcjellin atë në materialin e punuar prej tyre.			
<b>Detyrat dhe puna e pavarur:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ndërtoni në dokumentin <i>Word</i> një prezantim mbi aktivitetet në Ditën e Verës duke përdorur grafikun <i>SmartArt</i>, imazhe dhe tekst.</li> <li>2. Përcaktoni pozicionet e imazheve, tekstit dhe grafikëve <i>SmartArt</i> në dokument dhe më pas ruajeni dokumentin në formatin <i>PDF</i>.</li> <li>3. Hapni dokumentin PDF në <i>Acrobat Adobe DC</i> dhe modifikoni prezantimin tuaj duke ndryshuar dhe shtuar imazhe dhe tekst.</li> <li>4. Ruajini ndryshimet e bëra në dokumentin <i>PDF</i>.</li> </ol>			

## Planifikimi ditor (ditari)

<b>Fusha: Përpunimi digjital i të dhënave</b>	<b>Lënda: TIK</b>	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Tema mësimore:</b> 2.6 Veprimtari Praktike: Grafiku i të dhënave.	<b>Situata e të nxënit:</b> <i>Mbledhim të dhëna në klasë dhe më pas i paraqesim ato duke përdorur grafikët Chart dhe SmartArt</i>		
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:</b> • Kompetenca e të menduarit.			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi/ja: aftësohet të pasqyrojë të dhënat tabelore në formë grafike.	<b>Fjalët kyç:</b> Grafiku i të dhënave, <i>SmartArt</i>		
<b>Burimet:</b> Librat, revistat, kompjuteri dhe interneti.	<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> Artet, Edukimin fizik, Sportet dhe Shëndeti.		
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> praktikë dhe krijimtari.			
<b>Organizimi i orës së mësimin</b> 1. Krijoni një grafik që do të paraqesë numrin total të nxënësve që kanë ditëlindjen sipas muajve të vitit. 2. Pasi të keni siguruar informacionin me ditëlindjet e nxënësve, plotësoni tabelën në <i>Excel</i> . 3. Pasi janë plotësuar të dhënat, ndërtoni grafikun. 4. Modifikoni të dhënat e grafikut, duke shtuar një kolonë e cila do të paraqesë informacion mbi muajin e preferuar të nxënësve të klasës. Për këtë klikojmë grafikun dhe në seksionin <i>Data</i> klikojmë <i>Edit Data</i> , plotësojmë të dhënat sipas informacionit të mbledhur në klasë. Cili është muaji i preferuar nga nxënësit e klasës? 5. Modifikoni ngjyrat dhe stilin e paraqitjes së të dhënave. 6 Informacionin e mësipërm organizojeni në dokumentin <i>Word</i> së bashku me grafikun e ndërtuar. 9. Ruajeni dokumentin <i>Word</i> me një emër të përshtatshëm. 10. Nëpërmjet Komandës <i>File/Save As</i> ruajeni dokumentin në formatin <i>PDF</i> .			
<b>Vlerësimi:</b> nxënësi vlerësohet për idetë që sjell dhe prirjen për të përceptuar njohuri të reja.			

## Planifikimi ditor (ditari)

<b>Fusha: Kërkimi në web, emaili, interneti dhe chat-i</b>	<b>Lënda: TIK</b>	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Tema mësimore: 3.1 Prezantimi me internetin</b>	<b>Situata e të nxënit:</b> <i>Çfarë dini mbi internetin? Përse e përdorim atë?</i> <i>Çfarë të mirash kemi prej tij?</i>		
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:</b> • <i>kompetenca digjitale, e komunikimit dhe ajo e të menduarit.</i>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> • <i>koncepton internetin dhe kanalet e transmetimit të informacionit;</i> • <i>identifikon fushat e përdorimit të internetit.</i>	<b>Fjalët kyç:</b> <i>WWW (World Wide Web), kanale transmetimi, E-Commerce (transaksione online).</i>		
<b>Burimet:</b> kompjuteri dhe interneti.	<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> Gjuhët e komunikimit, Ekonominë etj.		
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b>  Metodat që do të përdoren do të jenë kombinimi i leksionit me punën në grupe të vogla si dhe diskutimin.  Leksioni do të fokusohet në përshkrimin e tekstit në formë prezantimi dhe do të kombinohet me brainstorming për konceptet e reja që përmban tema e mësimi.  Përsa i përket diskutimit, do të fokusohet më shumë në rastet specifike që kanë pasur mësuesit nga përvojat e tyre duke diskutuar bashkë me nxënësin.  Ndërsa puna me grupe të vogla do të përfshijë: debatin, studime rasti etj.			
<b>Organizimi i orës së mësimi</b>  Bashkëbisedim lidhur me temën mësimore.  Cilët janë format e kërkimit të informacionit në internet?  Për çfarë përdoret interneti?  Nxënësit japin shembuj mbi format e kërkimit të informacionit në internet.  Më pas diskutohet mbi shërbimet që ofron interneti për blerjen e produkteve <i>online</i> .			

Çfarë avantazhe dhe disavantazhe ka ky shërbim?

**Vlerësimi:** vlerësim në formë motivimi, evidentimi dhe kultivimi i prirjeve.

**Detyrat dhe puna e pavarur:**

1. Për çfarë përdoret interneti? Jepni shembuj të ndryshëm mbi përdorimin e tij.
2. Diskutoni mbi impaktin e internetit në jetën tuaj dhe të familjarëve tuaj.
3. A mundeni ju të jetoni pa internet dhe si do të ndryshonte jeta juaj nëse nuk do ta përdornit atë?
4. Çfarë mendoni mbi shërbimin që ofron interneti për blerjen e produkteve *online*.
5. Diskutoni mbi përparësitë dhe disavantazhet e këtij shërbimi.
6. Diskutoni dhe flisni për shërbimet e treguara në figurë.



*Dërgim email-esh*



*Komunikim*



*Blerje dhe rezervim online*




*Google Earth*




*Argëtim*



## Planifikimi ditor (ditari)

<b>Fusha: Kërkimi në web, email, interneti dhe chat-i</b>	<b>Lënda: TIK</b>	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Tema mësimore: 3.2 World Wide Web</b>		<b>Situata e të nxënit:</b>	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</b> <i>kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit, kompetenca personale.</i>		<i>Flisni mbi browser-at që njihni, çfarë dini rreth tyre?</i>	
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>koncepton funksionin e WWW;</i></li> <li>• <i>percepton një web browser, motor kërkimi;</i></li> <li>• <i>kujdeset për postimet e informacioneve në web.</i></li> </ul>		<b>Fjalët kyç:</b> <i>link hypertext, klient - server, URL, protokollin HTTP (Hypertext Transfer Protocol), ruter, serveri web.</i>	
<b>Burimet:</b> kompjuteri dhe interneti.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> Ekonominë, Gjuhët e komunikimit, Shkencat ekzakte etj.	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> punë praktike individuale dhe në grup.			
<b>Organizimi i orës së mësimin</b> 1. Diskutoni rreth rrjetit dhe mënyrës së komunikimit.			
			



2. Çfarë web browser-at, permendni disa prej tyre?



**Vlerësimi:** Vlerësim në formë motivimi, evidentimi dhe kultivimi i prirjeve.

**Detyrat dhe puna e pavarur:**

1. Cilët janë hapat që shërbejnë për funksionimin e www?
2. Çfarë është një web browser? Cili është qëllimi i përdorimit të tij?
3. Çfarë është një motor kërkimi?
4. Duke përdorur motorin e kërkimit <http://www.ask.com/> përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.
  - a) Sa peshon një pandë e madhe? b) Si marrin frymë yjet e detit?
  - c) Cili vend ha më shumë akullore? d) Sa herë astronautët kanë udhëtuar në Hënë?
  - e) Pse Hëna merr ngjyrë të kuqe? f) Sa tinguj të ndryshëm mund të lëshojë një mace?
5. Vizitoni këto faqe në internet. Çfarë informacioni mund të marrim prej tyre? Për çfarë përdoren këto faqe.
  - a) <http://www.wikipedia.org/> b) <http://www.amazon.com/>
  - c) <http://www.ebay.com/> d) <https://www.facebook.com/>
  - e) <https://www.gmail.com/>
6. Çfarë duhet të kemi kujdes gjatë postimeve në web?

## Planifikimi ditor (ditari)

<b>Fusha: Kërkimi në web, email, interneti dhe chat-i</b>	<b>Lënda: TIK</b>	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Tema mësimore:</b> 3.3 Veprimtari praktike: Përdorimi i motorëve të kërkimit	<b>Situata e të nxënësve:</b> Nxënësit ndahen në grupe dhe përcaktojnë detyra të ngjashme me veprimtarinë dhe ia drejtojnë ato njëri-tjetrit. Më pas ata vetëvlerësohen, duke argumentuar përgjigjet e grupit të tyre dhe të grupeve të tjera.		
<b>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyç:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit, kompetenca personale.</li> </ul>	<b>Fjalët kyç:</b>		
<b>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> aftësohet në përdorimin e motorëve të kërkimit.	<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> Gjeografinë, Gjuhët e komunikimit, Ekonominë etj.		
<b>Burimet:</b> kompjuteri, internet dhe një adresë emaili në gmail.com në mënyrë që të përdorim Google Sites.	<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> Stuhi mendimesh dhe trajtim praktik i teorisë së thelluar.		
<b>Organizimi i orës së mësimin</b> Nxënësit ndahen në grupe dhe përcaktojnë detyra të ngjashme me veprimtarinë dhe ia drejtojnë ato njëri-tjetrit. Më pas ata vetëvlerësohen, duke argumentuar përgjigjet e grupit të tyre dhe të grupeve të tjera. Nxënësit kërkojnë informacione të ndryshme <i>online</i> , si p.sh. informacione mbi temat mësimore, filmat apo lojërat e tyre të preferuara etj.			
<b>Vlerësimi:</b> vlerësim në bazë të punës praktike që nxënësit kanë realizuar.			
<b>Detyrat dhe puna e pavarur:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>Kërkime nga interneti:</li> <li>Mënyra e kërkimit të informacionit</li> <li>Fjalët kyç për kërkimin e një informacioni etj.</li> <li>Domonstrimi në klasë, komente dhe diskutime.</li> </ol>			

## Planifikimi ditor (ditari)

<b>Fusha: Kërkimi në web, email, interneti dhe chat-i</b>	<b>Lënda: TIK</b>	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Tema mësimore: 3.4 Protokollet</b>		<b>Situata e të nxënit:</b>	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:</b>		<i>Si dërgohen të dhënat nga një kompjuter në një tjetër? Si transferohet informacioni? Cila është rëndësia e protokolleve në komunikimin në internet?</i>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit, kompetenca personale.</li> </ul>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b>		<b>Fjalët kyç:</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>koncepton rrjetin kompjuterik;</li> <li>identifikon protokollet në internet;</li> <li>koncepton funksionin e protokolleve në internet.</li> </ul>		<i>protokolli HTTP, protokollu IP, Protokollu TCP, Telnet.</i>	
<b>Burimet:</b> kompjuteri dhe interneti.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b>	
		Ekonominë, Gjuhët e komunikimit etj.	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> praktikojmë njohuritë, punë individuale.			
<b>Organizimi i orës së mësimi</b>			
<i>Si ofrohet shërbimi i internetit? Çfarë janë protokollet? Diskutime rret temave kryesore të mësimi.</i>			
<b>Kompetencat që përfitojnë:</b> kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit, kompetenca personale.			
<b>Vlerësimi:</b> vlerësim për punën praktike, evidentimi dhe kultivimi i prirjeve.			
<b>Detyrat dhe puna e pavarur:</b>			
<ol style="list-style-type: none"> <li>Çfarë ofron ISP-ja dhe përse është e rëndësishme?</li> <li>Cilat janë protokollet kryesore që përdoren në internet?</li> <li>Cili është roli i protokolleve dhe si funksionojnë ato?</li> </ol>			

**Planifikimi ditor (ditari)**

<b>Fusha: Kërkimi në web, email, interneti dhe chat-i</b>	<b>Lënda: TIK</b>	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Tema mësimore:</b> 3.5 RSS dhe Podcast		<b>Situata e të nxënit:</b> Gjatë programimit në ëeb, kërkohet që të stilizohen faqe të shumta. Çfarë duhet bërë që të arrijmë një stilizim të thjeshtë dhe të krijojmë faqe sa më të bukura?	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:</b> <i>kompetenca digjitale, kompetenca personale.</i>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>koncepton CSS-në;</i></li> <li>• <i>vlërëson rëndësinë e integritit të CSS-së në HTML;</i></li> <li>• <i>identifikon mënyrat e ndryshme të integritit të CSS-së në HTML.</i></li> </ul>		<b>Fjalët kyç:</b> CSS, stilizim i jashtëm dhe i brendshëm.	
<b>Burimet:</b> kompjuteri dhe interneti.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> Dizenjim, teknologji komunikimi etj.	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> punë krijuese individuale.			
<b>Organizimi i orës së mësimin</b> <p>Nxënësit të ndarë në grupe diskutojnë për mënyrat e abonimit në njoftime të ndryshme në faqe web-i, blogje etj. Çfarë është Lajmi RSS? Mësuesi/ja sqaron ndryshimin ndërmjet RSS dhe Podcast.</p> <p>Më pas flitet për tipat e Pdcasteve dhe mënyrat e shkarkimit të tyre.</p> <p>Në fund të orës së mësimin, nxënësit praktikohen mbi mënyrat e abonimit në njoftimet SS.</p>			
<b>Vlerësimi:</b> vlerësim i punës së secilit/ës nxënësi/e.			
<b>Detyrat dhe puna e pavarur:</b> <i>Veprimtaria e tekstit mësimor</i> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Për çfarë shërben CSS?</li> <li>2. Cili është ndryshimi midis stilizimit të brendshëm dhe stilizimit të jashtëm?</li> <li>3. Nëse do të kishim faqe të shumta të cilat do të kishin të njëjtin stil CSS, cila do të ishte mënyra më e mirë për përzgjedhjen e vendosjes së kodit CSS? Argumentoni përgjigjen tuaj.</li> <li>4. Shkruani kodin që do të shfaqë tekstin “CSS dhe HTML” me ngjyrë blu dhe madhësi shkrimi 30 px, duke përdorur stilizimin e jashtëm.</li> </ol>			


## Planifikimi ditor (ditari)

<b>Fusha: Kërkimi në web, email, interneti dhe chat-i</b>	<b>Lënda: TIK</b>	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Tema mësimore:</b> 3.6 Disa mënyra komunikimi: <i>email-i, chat-i dhe forumi</i>		<b>Situata e të nxënit:</b> Flisni mbi adresën postare dhe adresën elektronike. Cilat janë mënyrat e komunikimit në internet? A keni dëgjuar për <i>forumet</i> ?	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>kompetenca e të nxënit, kompetenca digjitale.</i></li> </ul>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b>		<b>Fjalët kyç:</b> <i>email-i, chat-i, forumi.</i>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>vlërëson shërbimin e postës elektronike</i></li> <li>• <i>siguron postën elektronike nga sulmet dhe viruset;</i></li> <li>• <i>përdor chat-in;</i></li> <li>• <i>dallon ndryshimin e komunikimit të chat-it nga email-i;</i></li> <li>• <i>koncepton forumin në internet.</i></li> </ul>			
<b>Burimet:</b> kompjuteri dhe interneti.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> Gjeografinë, Letërsinë, Historinë etj.	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> stuhi mendimesh, punë krijuese individuale.			
<b>Organizimi i orës së mësimt</b>			
Çfarë është një adresë <i>emaili</i> ? Sqaroni pjesët përbërëse të saj. <a href="mailto:xxxx@gmail.com">xxxx@gmail.com</a>			
Të ndarë në grupe nxënësit flasin për rregullat e sigurisë si dhe sulmet e mundshme në adresat e <i>emailit</i> . Jepet koncepti <i>Spam, Phishing</i> etj.			
Cilat janë rregullat e komunikimit në <i>Chat</i> ?			
Nxënësit diskutojnë për forumet e ndryshme në internet.			
<b>Vlerësimi:</b> vlerësim në formë individuale me realizimin e detyrave përkatëse.			
<b>Detyrat dhe puna e pavarur:</b>			
1. Cilat janë mënyrat e ndryshme të komunikimit?			
2. Ku ndryshojnë <i>email-et, chat-et dhe forumet</i> ?			
3. Si mund t'i dallojmë <i>email-et spam</i> ?			
4. Cilat janë rregullat për të qenë të sigurt gjatë komunikimit në internet?			
5. Nxënësit dërgojnë <i>email</i> e njëri - tjetrit në bashkëpunim me mësuesin/en.			

## Planifikimi ditor (ditari)

<b>Fusha: Kërkimi në web, email, interneti dhe chat-i</b>	<b>Lënda: TIK</b>	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Tema mësimore:</b> 3.7 Veprimtari praktike: Përdorimi i aplikacioneve të <i>Google</i>		<b>Situata e të nxënit:</b> <i>Gjatë ndërtimit të faqeve web duhet të shtojmë lista të renditura, të përcaktojmë marxhinat dhe të identifikojmë elementet përbërëse të formularëve, të cilët shërbejnë për marrjen e të dhënave nga përdoruesi.</i>	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>kompetenca digjitale dhe e të nxënit.</li> </ul>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li><i>aftësohet mbi përdorimin e aplikacionit Google Groups;</i></li> <li><i>aftësohet mbi përdorimin e aplikacionit Google Docs.</i></li> </ul>		<b>Fjalët kyç:</b> <i>Google Groups, Google Docs.</i>	
<b>Burimet:</b> kompjuteri dhe interneti.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> Fizikën, Matematikën, Gjuhët e komunikimit etj.	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> vëzhgim i punës së nxënësve dhe diskutim në klasë.			
<b>Organizimi i orës së mësimin</b> Mësuesi jep informacione dhe koncepte bazë për metodën e komunikimit me një grup njerëzish, <i>Google Groups</i> dhe <i>Google Docs</i> . Bëhet një ndarje në grupe, ku krijuesi i grupit mund të kontrollojë se kush mund të shikojë përmbajtjen e grupit dhe se kush mund ta modifikojë atë. Nxënësit mund t'i përdorin grupet për të bashkëbiseduar me shokët/shoqet e klasës rreth lëndëve, sporteve, aktiviteteve jashtëshkollore etj.			
<b>Vlerësimi:</b> vlerësim me pikë.			
<b>Detyrat dhe puna e pavarur:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>Krijoni një grup të quajtur <i>Informatika</i>, me katër anëtarë.</li> <li>Krijoni një dokument duke përdorur <i>Google Docs</i>, në të cilin të shkruani mbi një aktivitet jashtëshkollor që keni zhvilluar. Këtë dokument shpërndajeni te pjesëtarët e tjerë të aktivitetit, në mënyrë të tillë që dhe ata të shkruajnë mbi këtë aktivitet.</li> </ol>			

## Planifikimi ditor (ditari)

<b>Fusha:</b> Hyrje në programim dhe Excel-i	<b>Lënda:</b> TIK	<b>Shkalla:</b> V	<b>Klasa:</b> VIII																																																						
<b>Tema mësimore:</b> 4.1 Formulatat dhe funksionet bazë të programit <i>Microsoft Excel</i> . Referencat relative, absolute dhe mikse		<b>Situata e të nxënimit:</b> Nga e kuptojmë që numri 5 në qelizën A3 mbart një formulë?																																																							
<b>Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyç:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit;</li> <li>kompetenca personale.</li> </ul>																																																									
<b>Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>vlëron rëndësinë e formulave dhe të funksioneve në Excel;</li> <li>koncepton dhe zbaton referencat relative, absolute dhe mikse.</li> </ul>		<b>Fjalët kyç:</b> formular, html.																																																							
<b>Burimet:</b> kompjuteri dhe interneti.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> Matematikë, Gjuhët e komunikimit.																																																							
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> teori dhe praktikë																																																									
<b>Organizimi i orës së mësimin</b> Ndërtoni tabelën e mëposhtme, e cila ruan të ardhurat për punonjësinnen Tedi Kote për disa muaj. <i>Duhet të gjeni: të ardhurat totale të tij; taksën që duhet të paguajë ai çdo muaj, duke pasur parasysh se taksa është 15% e të ardhurave.</i>																																																									
 <table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>A</th> <th>B</th> <th>C</th> <th>D</th> <th>E</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>2</td> <td></td> <td>Te ardhurat e Tedi Kote</td> <td></td> <td>Taksa per tu paguar</td> <td></td> </tr> <tr> <td>3</td> <td>janar</td> <td>32000</td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>4</td> <td>shkurt</td> <td>21000</td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>5</td> <td>mars</td> <td>28000</td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>6</td> <td>shuma</td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>7</td> <td></td> <td>taksa</td> <td></td> <td>15%</td> <td></td> </tr> <tr> <td>8</td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>					A	B	C	D	E	1						2		Te ardhurat e Tedi Kote		Taksa per tu paguar		3	janar	32000				4	shkurt	21000				5	mars	28000				6	shuma					7		taksa		15%		8					
	A	B	C	D	E																																																				
1																																																									
2		Te ardhurat e Tedi Kote		Taksa per tu paguar																																																					
3	janar	32000																																																							
4	shkurt	21000																																																							
5	mars	28000																																																							
6	shuma																																																								
7		taksa		15%																																																					
8																																																									
<b>Vlerësimi:</b> mësuesi vë në garë nxënësit për të evidentuar ata që kanë më tepër prirje.																																																									
<b>Detyrat dhe puna e pavarur:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>Cila është shenja që e bën adresën të ketë adresim absolut?</li> <li>Në qoftë se adresimi i qelizës është relative, si ndryshon ajo gjatë kopjimit?</li> <li>Kur e quajmë adresimin mikse?</li> </ol>																																																									



## Planifikimi ditor (ditari)

<b>Fusha: Hyrje në programim dhe Excel-i</b>	<b>Lënda: TIK</b>	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Tema mësimore:</b> 4.2 Filtrimi i avancuar dhe importimi i të dhënave në <i>Excel</i>		<b>Situata e të nxënit:</b> Si mund të gjejmë shpejt dhe saktë informacionin e duhur brenda një tabele? Përse duhet të importojmë të dhëna në <i>Excel</i> ?	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit,</li> <li>kompetenca e të menduarit.</li> </ul>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b>		<b>Fjalët kyç:</b> <i>filtrim i thjeshtë dhe filtrim i avancuar.</i>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>koncepton filtrimin e thjeshtë dhe të avancuar;</li> <li>mundëson importimin e të dhënave nga burime të ndryshme.</li> </ul>			
<b>Burimet:</b> kompjuteri dhe interneti.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> Shkencat e natyrës etj.	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> punë praktike individuale.			
<b>Organizimi i orës së mësimi</b>			
Ndërtoni një tabelë me listën emërore të nxënësve në klasë, datëlindjen e tyre, vendlindjen dhe notën mesatare të secilit. Duke përdorur komandën e filtrimit gjeni:			
<ul style="list-style-type: none"> <li>Sa prej tyre kanë lindur në Tiranë? Sa prej tyre kanë notën mesatare 8?</li> <li>Sa prej tyre kanë lindur në vitin 2002?</li> </ul>			
<b>Vlerësimi:</b> vlerësim në formë motivimi, evidentimi dhe kultivimi i prirjeve.			
<b>Detyrat dhe puna e pavarur:</b>			
<ol style="list-style-type: none"> <li>Çfarë kuptojmë me filtrim?</li> <li>Cilat janë llojet e avancuara të filtrimit?</li> <li>Krijoni një libër <i>Excel</i>-i për disa artikuj që keni blerë, duke ruajtur emrin e artikullit, çmimin, sasinë, datën e blerjes, datën e skadencës. Filtroni të dhënat për artikujt me çmim më të madh se 500 lekë. Hiqeni filtrin. Gjeni cilët artikuj skadojnë në vitin 2017?</li> <li>Krijoni një skedar në <i>Notepad</i>, i cili përmban emrin dhe mbiemrin e shokëve të tu. Importojeni atë në <i>Excel</i> në të dyja mënyrat.</li> <li>Gjeni një tabelë në internet dhe importojeni atë në <i>Excel</i>.</li> </ol>			

**Planifikimi ditor (ditari)**

<b>Fusha:</b> Hyrje në programim dhe excel-i	<b>Lënda:</b> TIK	<b>Shkalla:</b> V	<b>Klasa:</b> VIII
<b>Tema mësimore:</b> 4.3 Veprimtari praktike		<b>Situata e të nxënit:</b> Në jetën e përditshme kërkohet që të afishohet informacion në lidhje me një lajm të caktuar ose informacion mbi ndeshjet në kohë reale. Cili është ndryshimi midis këtyre faqeve dhe si krijohen ato?	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>kompetenca digjitale;</li> <li>kompetenca qytetare;</li> <li>kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit.</li> </ul>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> <i>Nxënësi/ja: aftësohet në përdorimin e formulave në Excel dhe filtrimin e të dhënave.</i>		<b>Fjalët kyç:</b> faqe statike, faqe dinamike.	
<b>Burimet:</b> kompjuteri dhe interneti.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> Gazetari, letërsi, sport etj.	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> punë në grupe			
<b>Organizimi i orës së mësimi</b> Klasa ndahet në grupe me 3-4 nxënës secili grup të cilët zhvillojnë veprimtarinë 1, 2 dhe 3 në libër. Vlerësohet grupi i cili bashkëpunon më mirë me njëri- tjetrin dhe zgjidhin në formën e duhur veprimtarinë. Më pas zhvillohet testi në formë gare.			
<b>Vlerësimi:</b> mësuesi evidenton prirjet e nxënësve dhe i motivon ata.			

## Planifikimi ditor (ditari)

<b>Fusha: Hyrje në programim dhe Excel-i</b>	<b>Lënda: TIK</b>	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Tema mësimore: 4.4 Hyrje në Visual Basic dhe mjedisi i punës</b>		<b>Situata e të nxënit:</b> Keni dëgjuar për aplikacionet? Po për gjuhët e programimit?	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>• kompetenca digjitale;</li> <li>• kompetenca personale.</li> </ul>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b>		<b>Fjalët kyç:</b> <i>Visual Basic, elementet e ndërfaqes IDE.</i>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>• koncepton gjuhën e programimit Visual Basic;</li> <li>• prezantohet me historikun e gjuhës së programimit Visual basic;</li> <li>• familjarizohet me mjedisin e punës në Visual Basic;</li> <li>• identifikon elementet e ndërfaqes IDE.</li> </ul>			
<b>Burimet:</b> kompjuteri dhe interneti.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> Gjuhët e komunikimit, Artet etj.	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> punë në grupe			
<b>Organizimi i orës së mësimin</b> Mësuesi/ja jep konceptin e programimit, gjuhën Visual Basic. Flet mbi etapat që ka evoluar VB. Nxënësit identifikojnë elementet e ndërfaqes IDE. Analizohen disa nga kontrollet e Toolbox-it, duke i demonstruar në laboratorin e informatikës.			
<b>Vlerësimi:</b> mësuesi evidenton prirjet e nxënësve dhe i motivon ata.			
<b>Detyrat dhe puna e pavarur:</b>			
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Çfarë është Visual Basic?</li> <li>2. Nëpër cilat etapa ka kaluar evoluimi i VB-së?</li> <li>3. Si hapet VBE?</li> <li>4. Çfarë kuptoni me projekt? Po me formë?</li> <li>5. Çfarë është Toolbox?</li> <li>6. Cilat janë disa nga kontrollet e Toolbox-it?</li> <li>7. Për çfarë shërben dritarja projekt?</li> </ol>			

## Planifikimi ditor (ditari)

<b>Fusha:</b> Hyrje në programim dhe excel-i	<b>Lënda:</b> TIK	<b>Shkalla:</b> V	<b>Klasa:</b> VIII																						
<b>Tema mësimore:</b> 4.5 Ndërtimi i një projekti		<b>Situata e të nxënit:</b> Si realizohen format? Po butonat?																							
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:</b>																									
<ul style="list-style-type: none"> <li>kompetenca e të shprehurit dhe të nxënit;</li> <li>kompetenca personale.</li> </ul>																									
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b>		<b>Fjalët kyç:</b> <i>Visual Basic, elementet e ndërfaqes IDE.</i>																							
<ul style="list-style-type: none"> <li>identifikon elemente të tjera të Visual Basic;</li> <li>përshkruan hapat në zhvillimin e një projekti;</li> <li>ekzekuton një aplikacion.</li> </ul>																									
<b>Burimet:</b> kompjuteri dhe interneti.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> Matematika etj.																							
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> punë në grupe																									
<b>Organizimi i orës së mësimin</b>																									
Nxënësit konceptojnë disa nga vetitë më të rëndësishme të listës për formën ose kontrollin.																									
<table> <thead> <tr> <th><b>Emri i atributit</b></th> <th><b>Objektivi</b></th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td><i>Name</i></td> <td>Paraqet emrin e objektit</td> </tr> <tr> <td><i>Caption</i></td> <td>Emri shfaqet në objekt</td> </tr> <tr> <td><i>BackColor</i></td> <td>Ngjyra e sfondit për objektin</td> </tr> <tr> <td><i>ForeColor</i></td> <td>Ngjyra e tekstit të shkruar në objekt</td> </tr> <tr> <td><i>Font</i></td> <td>Tipi dhe madhësia e shkrimit</td> </tr> <tr> <td><i>Visible</i></td> <td>Mjeti është i dukshëm ose i padukshëm</td> </tr> <tr> <td><i>Height</i></td> <td>Gjatësia e objektit</td> </tr> <tr> <td><i>Width</i></td> <td>Gjerësia</td> </tr> <tr> <td><i>Text</i></td> <td>Lejon shkrimin dhe editimin e tekstit në objekt</td> </tr> <tr> <td><i>Value</i></td> <td>Vlera që ka kontrolli</td> </tr> </tbody> </table>				<b>Emri i atributit</b>	<b>Objektivi</b>	<i>Name</i>	Paraqet emrin e objektit	<i>Caption</i>	Emri shfaqet në objekt	<i>BackColor</i>	Ngjyra e sfondit për objektin	<i>ForeColor</i>	Ngjyra e tekstit të shkruar në objekt	<i>Font</i>	Tipi dhe madhësia e shkrimit	<i>Visible</i>	Mjeti është i dukshëm ose i padukshëm	<i>Height</i>	Gjatësia e objektit	<i>Width</i>	Gjerësia	<i>Text</i>	Lejon shkrimin dhe editimin e tekstit në objekt	<i>Value</i>	Vlera që ka kontrolli
<b>Emri i atributit</b>	<b>Objektivi</b>																								
<i>Name</i>	Paraqet emrin e objektit																								
<i>Caption</i>	Emri shfaqet në objekt																								
<i>BackColor</i>	Ngjyra e sfondit për objektin																								
<i>ForeColor</i>	Ngjyra e tekstit të shkruar në objekt																								
<i>Font</i>	Tipi dhe madhësia e shkrimit																								
<i>Visible</i>	Mjeti është i dukshëm ose i padukshëm																								
<i>Height</i>	Gjatësia e objektit																								
<i>Width</i>	Gjerësia																								
<i>Text</i>	Lejon shkrimin dhe editimin e tekstit në objekt																								
<i>Value</i>	Vlera që ka kontrolli																								
Nxënësit nën mbikqyrjen e mësuesit ndjekin hapat për kryerjen e një aplikacioni																									
Ka tre hapa kryesorë që na çojnë në krijimin e aplikacioneve në Visual Basic:																									
1. dizenjimi i ndërfaqes së përdoruesit;																									
2. vendosja e vlerave të attributeve të kontrolleve;																									
3. vendosja e kodit në kontroll.																									

**Shembull**

Dizenjimi i një forme me një *text box* dhe *dy butona*.


*Krijimi i ndërfaqes:* fillimisht do të ndërtojmë formën dhe më pas do të vendosim objektet mbi të. Shtojmë një *Text Box* në formë dhe e vendosim në qendër të saj.

Shtojmë dy butona në formë duke klikuar në buton dhe duke tërhequr mausin për në formë.

*Vendosja e vetive:* në këtë shembull do të ndryshojmë tri veti që jepen në tabelën në vijim.

<b>Objekti</b>	<b>Atributi</b>	<b>Vlera</b>
<i>UserForm1</i>	<i>Name</i>	Form1
	<i>Caption</i>	Shembull1
	<i>Font</i>	Bold me madhësi 12
<i>Commandbutton1</i>	<i>Name</i>	Command1
	<i>Caption</i>	Po
	<i>Font</i>	Bold me madhësi 12
<i>Commandbutton2</i>	<i>Name</i>	Command2
	<i>Caption</i>	Mbylle
	<i>Font</i>	Bold me madhësi 12
<i>TextBox</i>	<i>Name</i>	Text1
	<i>Text</i>	Bosh
	<i>Font</i>	Bold me madhësi 12

Ndërtoni një formë me grupe nxënësish.



**Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen me notë.

**Detyrat dhe puna e pavarur:**

Dizenjoni një formë si në figurë, me tre *TextBox*, tre *Label* dhe një *CommandButton*.

## Planifikimi ditor (ditari)

<b>Fusha: Hyrje në programim dhe Excel-i</b>	<b>Lënda: TIK</b>	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Tema mësimore:</b> 4.6 Variablat dhe përdorimi i tyre Operatorët në Visual basic	<b>Situata e të nxënit:</b> Variabli është emri i një zone të kujtesës së kompjuterit ku ruajmë informacion. Si identifikohen dhe deklarohen variablat? Çfarë janë operatorët dhe operandat në <i>Visual Basic</i> ?		
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>kompetenca e të shprehurit dhe të nxënit, kompetenca personale.</li> </ul>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>koncepton variablat;</li> <li>identifikon tipat e të dhënave që përdoren në <i>Visual Basic</i>;</li> <li>përdor variablat;</li> <li>identifikon operatorët dhe operandat në <i>Visual Basic</i>.</li> </ul>	<b>Fjalët kyç:</b> skripti në JS.		
<b>Burimet:</b> kompjuteri dhe interneti.	<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> Matematika, etj.		
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> punë në grup, vëzhgim dhe ekzekutimi i komandave.			
<b>Organizimi i orës së mësimin</b> Mësuesi/ja jep konceptin e variablave dhe tipin e të dhënave. Çfarë janë operatorët dhe operandat në <i>Visual Basic</i> ? Jepen shembuj konkretë nga jeta e përditshme si operatorët aritmetikë, krahasues dhe logjikë. Nxënësit ndahen në grupe dhe dizenojnë forma dhe shkruajnë kodin përkatës me ndihmën e mësuesit/es.			
<b>Vlerësimi:</b> mësuesi/ja vlerëson nxënësin/en për njohuritë që ka rreth gjuhëve të programimit dhe diskutimet që sjell në klasë për variablat dhe përdorimin i tyre.			
<b>Detyrat dhe puna e pavarur:</b> Dizenjoni një formë, që do të krahasojë nëse numri i parë është më i vogël se numri i dytë. Kodi të vendoset në butonin <i>Krahaso</i> .			

## Planifikimi ditor (ditari)

<b>Fusha:</b> Hyrje në programim dhe excel-i	<b>Lënda:</b> TIK	<b>Shkalla:</b> V	<b>Klasa:</b> VIII
<b>Tema mësimore:</b> 4.7 Disa funksione të rëndësishme në Visual Basic.		<b>Situata e të nxënit:</b> <i>Një procedurë është një grup shprehjesh që së bashku kryejnë një detyrë kur thirren.</i>	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:</b> • <i>kompetenca digjitale.</i>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> • <i>koncepton funksionet dhe procedurat në Visual Basic;</i> • <i>përdor funksionin MsgBox();</i> • <i>përdor funksionin InputBox().</i>		<b>Fjalët kyç:</b> PHP, server - side.	
<b>Burimet:</b> kompjuteri dhe interneti.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> Matematika etj.	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> diskutim mbi avantazhet dhe karakteristikat që ofron PHP.			
<b>Organizimi i orës së mësimimit</b> Nxënësit konceptojnë procedurën nëpërmjet shembujve që u jep mësuesi/ja <b>Shembull</b> Sub Nxënësi() Dim emri As String emri = "Alban Testi" End Sub  <i>Më tej jepet koncepti i funksionit dhe i krijimit të tij. Cilat janë funksionet kresore. Jepen shembuj konkretë të përdorimit të tyre për të afishuar një mesazh.</i> <i>Bashkë të ndarë në grupe nxënësit ndërtojnë forma të ndryshme që e pyet përdoruesin për autorin e librit "Aventurat e Tom Sojerit" dhe, pasi përdoruesi shkruan përgjigjen, ajo afishohet.</i>			
<b>Vlerësimi:</b> vlerësimi me notë			
<b>Detyrat dhe puna e pavarur:</b> 1. Çfarë kuptoni me procedurë? Nga ndryshon funksioni nga procedura? 2. Për çfarë shërben funksioni <i>MsgBox()</i> ? 3. Për çfarë shërben funksioni <i>InputBox()</i> ?			

## Planifikimi ditor (ditari)

<b>Fusha: Hyrje në programim dhe excel-i</b>	<b>Lënda: TIK</b>	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Tema mësimore:</b> 4.8 Veprimtari praktike: Shembuj të ndryshëm në Visual Basic		<b>Situata e të nxënit:</b> <i>Praktikë me shembuj të ndryshëm në VB.</i>	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>kompetenca e të menduarit dhe të zhvillimit të koncepteve në botën e teknologjisë.</li> </ul>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Zhvillimi i aftësive mbi përdorimin e VB.</li> </ul>		<b>Fjalët kyç:</b> domain, host, protokollu FTP.	
<b>Burimet:</b> kompjuteri dhe interneti.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> Shkencat e komunikimit, matematika, etj.	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> punë në grupe mbi njohjen dhe praktikën për publikimin e faqeve Web.			
<b>Organizimi i orës së mësimin</b> Nxënësit ndahen në grupe dhe kryejnë këto veprimtari. Më pas analizojnë rezultatet midis grupeve me ndihmën e mësuesit/es. <b>Veprimtaria 1. Gjetja e vlerës kubike për një numër të dhënë nga përdoruesi</b> Për të ndërtuar këtë program nevojiten: një formë, një <i>TextBox</i> , dy <i>Label</i> dhe një buton për kryerjen e llogaritjeve. <b>Veprimtaria 2.</b> Krijoni një projekt në <i>Visual Basic</i> për të gjetur perimetrin dhe sipërfaqen e një katrori. Dizenjoni formën në mënyrë që vlera e brinjës <b>A</b> të vendoset në një kuti teksti dhe të shfaqë perimetrin dhe sipërfaqen në kuti të tjera teksti. <b>Veprimtaria 3.</b> Krijoni një projekt në <i>Visual Basic</i> për të gjetur perimetrin dhe sipërfaqen e një trekëndëshi, duke përdorur formulat si në tekst.			
<b>Vlerësimi:</b> vlerësim në formën e pyetjeve dhe përgjigjeve dhe në bazë të analizës së tyre vlerësimi bëhet me pikë.			
<b>Detyrat dhe puna e pavarur:</b> Kryerja e ushtrimeve të ngjashme në shtëpi ose të ndarë në grupe.			



## Planifikimi ditor (ditari)

<b>Fusha:</b> Hyrje në programim dhe Excel-i	<b>Lënda:</b> TIK	<b>Shkalla:</b> V	<b>Klasa:</b> VIII
<b>Tema mësimore:</b> 4.9 Integrimi i <i>Visual Basic</i> në <i>Excel</i> .	<b>Situata e të nxënit:</b> Për të llogaritur vlera të caktuara në <i>Excel</i> , duhet të shkruhen formulat në çdo qelizë që do të përdoren, dhe kjo e bën të vështirë punën me <i>Excel</i> -in. Gjithashtu është i vështirë modifikimi i sigurt dhe i besueshëm i faqeve të <i>Excel</i> -it kur përdoren nga disa përdorues. <i>Visual Basic Editor</i> është një program në <i>Excel</i> që na lejon të komunikojmë me të.		
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>kompetenca digjitale.</li> </ul>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>koncepton VBA si gjuhë programimi në aplikacione Windows;</li> <li>krijon Macro dhe e përdor atë;</li> <li>përdor funksionin MsgBox.</li> </ul>	<b>Fjalët kyç:</b> <i>Visual Basic për Aplikacione, Macro.</i>		
<b>Burimet:</b> kompjuteri dhe interneti.	<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> Gjuhët e komunikimit, Matematika etj.		
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> diskutim dhe punë në grupe			
<b>Organizimi i orës së mësimin</b> Mësuesi/ja shpjegon mbi rëndësinë e <i>Visual Basic</i> për aplikacione. Jepet koncepti i <i>Makros</i> dhe qëllimi i saj për aplikime të stileve dhe formatimeve, për manipulime të të dhënave, teksteve etj. Më pas nxënësit shkruajnë një <i>makro</i> që gjen shumën e tre numrave të vendosur në qeliza të përcaktuara në <i>Excel</i> . Nxënësit shkruajnë një <i>makro</i> që gjen produktin e dy numrave të vendosur në qeliza të parcaktuara dhe afishon një mesazh me vlerën e gjetur. Mësuesi/ja shpjegon mënyrën e regjistrimit të një <i>makroje</i> si dhe ekzekutimin e saj			
<b>Vlerësimi:</b> vlerësim në formë motivimi, evidentimi dhe kultivimi i prirjeve.			
<b>Detyrat dhe puna e pavarur:</b> Ushtrime të ngjashme me mësimin. Të ndërtohet një makro dhe të ekzekutohet.			

## Planifikimi ditor (ditari)

<b>Fusha:</b> Hyrje në programim dhe Excel-i	<b>Lënda:</b> TIK	<b>Shkalla:</b> V	<b>Klasa:</b> VIII
<b>Tema mësimore:</b> 4.10 Kontroll njohurish		<b>Situata e të nxënit:</b> Vlerësim njohurish mbi tematikën 4	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>kompetenca digjitale.</i></li> </ul>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b>		<b>Fjalët kyç:</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>zgjidh ushtrimet dhe pyetjet teorike në mënyrë të saktë në bazë të njohurive të marra;</i></li> <li>• <i>hulumton në internet për ekzekutimin e programit në PHP;</i></li> <li>• <i>ndërton formularë dhe ekzekuton në mënyrë të suksesshme programet.</i></li> </ul>			
<b>Burimet:</b> kompjuteri dhe interneti.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b>	
		Gjuhët e komunikimit, Matematika etj.	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> punë individuale për zgjidhjen e ushtrimeve dhe hulumtim në internet për të shpjeguar kodin në PHP.			
<b>Organizimi i orës së mësimin</b>			
Së pari bëhet një përsëritje për temat e trajtuara deri tani dhe më pas secili nxënës zgjidh në libër ushtrimin 1, ku duhet të përcaktojë për çdo pyetje <i>e vërtetë</i> apo <i>e gabuar</i> . Ushtrimi 2 mund të lihet detyrë shtëpie, pasi kërkohet të hulumtohet në internet. Në këtë ushtrim, mësuesi jep orientimet e tij. Më pas vazhdohet me zgjidhjen në mënyrë të suksesshme të ushtrimit 3, ku kërkohet të ndërtohet një formë për fjalëkalimin. Ushtrimi duhet të ekzekutohet për të parë nëse rezultati i afishuar është i njëjtë si në figurë. Ushtrimin 4, nxënësit duhet ta ekzekutojnë dhe të shpegojnë rezultatin që do të shfaqet në <i>broëser</i> .			
<b>Kompetencat që përfitojnë:</b>			
<b>Vlerësimi:</b> vlerësim në formë motivimi, evidentimi dhe kultivimi i prirjeve.			
<b>Detyrat dhe puna e pavarur:</b>			
Veprimtaria e tekstit mësimor. Ushtrimi numër 2 jepet detyrë shtëpie.			

## Planifikimi ditor (ditari)

<b>Fusha: Prezantimi digjital (komunikimi funksional)</b>	<b>Lënda: TIK</b>	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Tema mësimore:</b> 5.1 Shtimi i imazheve në prezatimin PowerPoint	<b>Situata e të nxënit:</b> Nxënësit, të ndarë në grupe, prezantojnë në klasë projektin e tyre me temë: “Tirana, kryeqyteti i Shqipërisë”. Sa e rëndësishme është vendosja e imazheve gjatë një prezantimi?		
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>kompetenca personale,</i></li> <li>• <i>kompetenca e të shprehurit dhe të nxënit.</i></li> </ul>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• vendos imazhe në prezantim;</li> <li>• krijon albume fotografike në PowerPoint.</li> </ul>	<b>Fjalët kyç:</b> imazh, album fotografik.		
<b>Burimet:</b> kompjuteri dhe interneti.	<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> Matematikën, Gjuhët e komunikimit, Arti pamor.		
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> punë individuale si dhe bashkpunim me mësuesin			
<b>Organizimi i orës së mësimin</b> Tema e re fillohet me një njohje të nxënësve ndaj programit më të përdorshëm për prezantimin e dokumenteve digjitale, <i>Microsoft PowerPoint</i> . Gjithashtu këtu tregohet dhe si mund të shtojmë imazhe në prezatim nga një skedar si dhe shtimi i tyre <i>online</i> . Shpjegohet dhe koncepti i albumeve fotografike në <i>PowerPoint</i> dhe si t’i krijojmë ato.			
<b>Vlerësimi:</b> vlerësimi në formë motivimi, evidentimi dhe kultivimi i prirjeve.			
<b>Detyrat dhe puna e pavarur:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Krijoni një skedar “Festat e fundvitit”.</li> <li>2. Në këtë skedar vendosni imazhet mbi festat e fundvitit.</li> <li>3. Krijoni një prezantim në të cilin të paraqisni pesë fotografite më të bukura.</li> <li>4. Në slide-in e parë shtoni një fotografi nga interneti që pasqyron një ambient festiv.</li> <li>5. Vendosni titujt për secilën fotografi.</li> <li>6. Shfaqni prezantimin tuaj.</li> </ol>			

## Planifikimi ditor (ditari)

<b>Fusha: Prezantimi digjital (komunikimi funksional)</b>	<b>Lënda: TIK</b>	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Tema mësimore:</b> 5.2 Shtimi dhe stilizimi i tabelave dhe i grafikëve në <i>PowerPoint</i>		<b>Situata e të nxënit:</b> Shpesh, gjatë prezantimeve na duhet të vendosim informacione që përmbajnë të dhëna numerike. Si e realizojmë këtë?	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>• kompetenca digjitale</li> <li>• kompetenca personale;</li> <li>• kompetenca e të nxënit.</li> </ul>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b>		<b>Fjalët kyç:</b> stilizim i tabelave dhe i grafikëve.	
<ul style="list-style-type: none"> <li>• përdor tabelat dhe grafikët në prezantim;</li> <li>• stilizon tabelat dhe grafikët sipas dëshirës.</li> </ul>			
<b>Burimet:</b> kompjuteri dhe interneti.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> Matematikën, Gjuhët e komunikimit.	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> punë individuale.			
<b>Organizimi i orës së mësimin</b>			
Në këtë temë trajtohen:			
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shtimi i tabelave në prezantim. Stilizimi i tabelave.</li> </ul>			
Trajtohen shembuj për shtimin e tabelave dhe afishimin e informacione në bazë të kërkesave. Mund të ndryshojmë paraqitjen e tabelës, në mënyrë që ajo të lexohet me lehtësi duke përzgjedhur një stilizim të veçantë. Grafiku është një tjetër element i mësimin që duhet studiuar mbi mënyrat e paraqitjes.			
<b>Vlerësimi:</b> vlerësim për konceptet dhe argumentet që trajtohen.			
<b>Detyrat dhe puna e pavarur:</b>			
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ndërtoni një tabelë që do të afishojë sipërfaqen e kontinenteve.</li> <li>2. Ndërtoni një tabelë që do të afishojë pesë shtetet me popullsi më të madhe.</li> <li>3. Stilizoni tabelën e krijuar dhe shpjegoni veprimet që keni kryer.</li> <li>4. Në slide shtoni fotografinë e shtetit që ka popullsinë më të madhe.</li> </ol>			

## Planifikimi ditor (ditari)

<b>Fusha: Prezantimi digjital (komunikimi funksional)</b>	<b>Lënda: TIK</b>	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Tema mësimore:</b> 5.3 Animimi i objekteve		<b>Situata e të nxënit:</b> Çfarë elementesh futen në <i>PowerPoint</i> për të tërhequr vëmendjen e audiencës? Si realizohet lëvizja e objekteve të ndryshme?	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave krye:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>kompetenca digjitale</li> <li>kompetenca personale;</li> <li>kompetenca e të nxënit.</li> </ul>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>identifikon llojet e animimeve në <i>PowerPoint</i>;</li> <li>zbaton animacionet në imazh dhe grafik. <i>koncepton klasat dhe objektet.</i></li> </ul>		<b>Fjalët krye:</b> animimi, entrance, emphasis, exit, motion paths.	
<b>Burimet:</b> kompjuteri dhe interneti.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> Gjuhët e komunikimit, Mjedisin, Matematikën etj.	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> ndërthurje e teorisë me jetën reale.			
<b>Organizimi i orës së mësimin</b> Në këtë temë duhet bërë kujdes në zbërthimin e koncepteve të animimit. Në <i>PowerPoint</i> mund të animohen tekstet, fotografitë, grafikët etj. Animimet në prezantim përdoren për të tërhequr vëmendjen e audiencës ose që prezantimi të bëhet më i lexueshëm dhe i kuptueshëm. Nxënësi njihet me llojet a animimeve si: - <i>Entrance; Emphasis; Exit; Motion Paths</i> . Trajtohen shembull për shtimin e efekteve auditive.			
<b>Vlerësimi:</b> vlerësimi në formë motivimi, evidentimi dhe kultivimi i prirjeve.			
<b>Detyrat dhe puna e pavarur:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>Ndërtoni një prezantim në të cilin të afishoni imazhe dhe grafikë.</li> <li>Aplikoni animimet e ndryshme në prezantim.</li> <li>Tregoni llojet e aplikimeve që keni përdorur.</li> </ol>			

## Planifikimi ditor (ditari)

<b>Fusha: Prezantimi digjital (komunikimi funksional)</b>	<b>Lënda: TIK</b>	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Tema mësimore:</b> 5.4 Prezantimet në <i>Prezi</i>		<b>Situata e të nxënit:</b> A keni dëgjuar për prezantimet online? Si shpërndahen ato në rrjetet sociale?	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>kompetenca digjitale; kompetenca personale; kompetenca e të nxënit.</li> </ul>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>koncepton prezantimin online dhe offline;</li> <li>përdor Prezin si program prezantues;</li> <li>identifikon pjesët kryesore të prezantimit në Prezi;</li> <li>realizon një prezantim me anë të Prezit.</li> </ul>		<b>Fjalët kyç:</b> prezantim online dhe offline.	
<b>Burimet:</b> kompjuteri dhe internet.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> Gjuhët e komunikimit, Matematikën etj.	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> ndërthurje e teorisë me praktikën, punë individuale në kompjuter.			
<b>Organizimi i orës së mësimin</b> Për të zhvilluar temën e re, si fillim i referohemi koncepteve prezantimi <i>online</i> dhe <i>offline</i> si dhe dallimi ndërmjet tyre. Nxënësit duhet të njihen me <i>Prezin</i> si dhe mund të bëhet një prezantim me anë të tij <i>online</i> . Të trajtohen thjesht dhe qartë hapat për përzgjedhjen e modelit në <i>Prezi</i> . Nxënësit duhet të njihen me zonat që përbëjnë pjesët kryesore të prezantimit me anë të <i>Prezit</i> si dhe të dinë veçoritë e tyre.			
<b>Vlerësimi:</b> vlerësimi do të bazohet në pyetjet teorike dhe përgjigjen saktë të pyetjeve.			
<b>Detyrat dhe puna e pavarur:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>Krijoni një llogari në Prezi.</li> <li>Krijoni një prezantim në Prezi që do të afishojë informacion mbi disa kafshë të cilat janë në rrezik zhdukjeje.</li> <li>Vendosni në prezantimin tuaj imazhe me këto kafshë.</li> <li>Ruajeni dhe prezantoheni punimin tuaj.</li> </ol>			

**Planifikimi ditor (ditari)**

<b>Fusha: Prezantimi digjital (komunikimi funksional)</b>	<b>Lënda: TIK</b>	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Tema mësimore:</b> 5.5 Punë praktike: Prezantim me anë të Prezit, “Klasifikimi i kafshëve”		<b>Situata e të nxënit:</b> Përgatitja e projektit	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Kompetenca personale,</i></li> <li>• <i>kompetenca e të shprehurit dhe të nxënit,</i></li> <li>• <i>kompetenca digjitale.</i></li> </ul>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• realizon një projekt në një nga lëndët e shkollës me anë të programit prezantues online PREZI.</li> </ul>		<b>Fjalët kyç:</b>	
<b>Burimet:</b> kompjuteri dhe internet.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> Gjuhët e komunikimit, Art pamor etj.	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> ndërthurje e teorisë me praktikën, punë individuale ose në grupe të voglanë kompjuter.			
<b>Organizimi i orës së mësimit</b> Hapat e projektit: <ul style="list-style-type: none"> <li>• hapni programin prezantues <a href="http://www.prezi.com">www.prezi.com</a>;</li> <li>• futuni në llogarinë tuaj;</li> <li>• klikoni në butonin Create a new Prezi;</li> <li>• zgjidhni prezantimin e gatshëm EXAMINATION;</li> <li>• plotësoni zonat me të kuqe si në figurë për të mbushur hapësirën e programit.</li> </ul>			
Mësuesi/ja pyet nxënësit si e konceptojnë këtë projekt dhe u jep detyre shtëpie			
<b>Detyrat dhe puna e pavarur:</b>			

**Planifikimi ditor (ditari)**

<b>Fusha: Prezantimi digjital (komunikimi funksional)</b>	<b>Lënda: TIK</b>	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Tema mësimore:</b> 5.6 Tema: “Të jetojmë në një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm”	<b>Situata e të nxënit:</b> Prezantimi i projektit		
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>kompetenca personale; kompetenca e të menduarit; kompetenca për jetën, si sipërmarrjen dhe mjedisin.</li> </ul>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>demonstron prezantimet e tij/saj në klasë,</li> <li>krahason dhe analizon formën e prezantimit dhe efektshmërinë e tij lidhur me temën e përcaktuar</li> </ul>	<b>Fjalët kyç:</b>		
<b>Burimet:</b> kompjuteri, internet.	<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> Art pamor, Gjuhët e komunikimit, qytetaria, mjedisi.		
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> ndërthurje e teorisë me praktikën, punë individuale.			
<b>Organizimi i orës së mësimi</b> Mësues-i/ja sistemon informacionin e marrë nga nxënësit nëpërmjet pyetjeve të tilla, si: <ol style="list-style-type: none"> <li>Në çfarë programi është ndërtuar pyetësi dhe si është shtjelluar ai?</li> <li>Sa individë janë të përfshirë në këtë projekt? Si janë hedhur të dhënat në Excel dhe sa për qind e prindërve janë përfshirë në këtë projekt?</li> <li>Ku janë bazuar nxënësit për marrjen e informacionit të duhur dhe të vlefshëm?</li> <li>Çfarë burimi informacioni është përdorur?</li> </ol>			
<b>Vlerësimi:</b> vlerësim i punës së secilit/ës nxënësi/e.			
<b>Detyrat dhe puna e pavarur:</b>			



**Planifikimi ditor (ditari)**

<b>Fusha: Prezantimi digjital (komunikimi funksional)</b>	<b>Lënda: TIK</b>	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: VIII</b>
<b>Tema mësimore:</b> 5.7 Tema: “Të jetojmë në një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm”.	<b>Situata e të nxënit:</b> Prezantimi final		
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit, kompetenca personale, kompetenca digjitale.</li> </ul>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>demonstron prezantimet e tij/saj në klasë, krahason dhe analizon formën e prezantimit dhe efektshmërinë e tij lidhur me temën e përcaktuar</li> </ul>	<b>Fjalët kyç:</b>		
<b>Burimet:</b> kompjuteri, interneti.	<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:</b> Gjuhët e komunikimit, qytetaria, mjedisi.		
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> motivohen dhe inkurajohen nxënësit në prezatimin final.			
<b>Organizimi i orës së mësimi</b> Pasi janë përzgjedhur punët më të mira, në fazën e fundit bëhet prezantimi i materialit përfundimtar në një mjedis të madh, ku janë të ftuar nxënës të shkollës, të komunitetit, prindër dhe individë nga organizatat mjedisore. <ul style="list-style-type: none"> <li>Fillimisht bëhet prezantimi i projektit, jepet qëllimi dhe pritshmëria e tij.</li> <li>Nxënësit prezantojnë temën e projektit me mënyra të ndryshme në dy programe, në PowerPoint dhe në Prezi. Gjatë prezantimit cilësohet gjendja aktuale me fotografi dhe me informacion nga aktualiteti, dhe në fund jepen mënyrat, strategjitë dhe rrugët për një mjedis sa më të pastër.</li> <li>Në fund shpëndahen fletëpalosje për pjesëmarrësit, të krijuar po nga nxënësit.</li> <li>Pjesëmarrësve u tregohen format e shtrirjes së projektit, duke pasur parasysh shtrirjen në rrjetet sociale, në forume të ndryshme.</li> </ul>			
<b>Vlerësimi:</b> vlerësim përmes detyrave individuale.			

**CIP Katalogimi në botim BK Tiranë**

Maxhelaku, Suela

Informatika 10: Udhëzues për mësuesin /

Suela Maxhelaku,

Esmeralda Tasho. – Tiranë : Irisoft, 2016

156 f. ;20.7 x 27.7 cm.

ISBN 978-9928-4362-7-6

I.Tasho, Esmeralda

1.Shkenca e kompjuterit 2.Tekste për

mësuesit 3.Tekste për

shkollat e mesme

004 (072) (075.3)